



Empowered lives.  
Resilient nations.

# “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore - kusht për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave ekonomike në familje”

Njohja dhe zbatimi i Konventës së Hagës nr. 38: “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”

*Tiranë, 2017*

**Titulli i Projektit:** “Ndjekja e rasteve të litigimit strategjik në mbrojtje të të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe familjarëve në çështjet e divorcit”

Ky raport-analizë u bë i mundur falë mbështetjes së ofruar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me fonde të qeverisë së Suedisë. Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e UNDP-së apo të Qeverisë suedeze.

**Hartuan raportin:** Dr. Av. Evis Garunja, Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi, Prof. Dr. Arta Mandro.

**Ndihmuan për hartimin e Raportit:** Vjosa Zaimi (gjyqtare), Av. Aurela Bozo, Av. Iris Aliaj

**Oponente:** Av. Rezarta Abdiu

# Përmbajtja e Lëndës

Hyrje 5

Metodologjia 7

<b>1.</b>	<b>Njohuri të përgjithshme mbi Konventat e Hagës me objekt detyrimin për ushqim. Çfarë profesionistët duhet të dinë</b>	<b>9</b>
1.1.	Konventat e ratifikuara nga Shqipëria me objekt detyrimin për ushqim	9
1.2.	“Konventa mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore” [nr. 23]	11
1.3.	Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore[nr.24]	12
<b>2.</b>	<b>Konventa “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” [nr 38]</b>	<b>13</b>
2.1.	Objekti i Konventës	13
2.2.	Fusha e zbatimit	15
2.3.	Kriteret e kompetencës: autoriteti qendror	15
2.4.	Detyrimet për shtetet nënshkruese	16
2.5.	Rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë detyrimin për ushqim apo forma të tjera të mbështetjes financiare ndaj anëtarëve të familjes	18
2.6.	Rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e marrëveshjeve që përmbajnë detyrimin për ushqim	21
2.7.	Situata kur 2 shtetet janë ‘shtete origjine’	22
2.8.	Parimi i mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	22
2.9.	Organi publik në rolin e kërkuesit	23

2.10. Kërkesa të drejtpërdrejta ndaj autoriteteve kompetente dhe shtete me disa juridiksione. Raporti me konventat e tjera	23
2.11. Çështje praktike me rëndësi	25
<b>3. Praktika të mira të ndërveprimit midis shteteve të ndryshme dhe rasti i ndërveprimit në Bashkimin Evropian (rasti i Rregullores CE N. 4/2009 Mbi detyrimet ushqimore). Rasti i Italisë dhe Gjermanisë</b>	<b>27</b>
3.1. Si realizohet përmbushja e detyrimeve ushqimore në kuadër të zbatimit të Konventës së Hagës, sipas të drejtës italiane	31
3.2. Si realizohet përmbushja e detyrimeve ushqimore në kuadër të zbatimit të Konventës së Hagës sipas të drejtës gjermane	33
<b>4. Situata reale mbi zbatimin në Shqipëri të Konventës së Hagës</b>	<b>37</b>
4.1. Kuadri Ligjor ekzistues mbi detyrimin ushqimor për fëmijët dhe ekzekutimin e tij	37
4.2. Problematika mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës familjare, konkretisht me detyrimet ushqimore	44
Konkluzione nga studimi dhe monitorimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pensionin ushqimor për fëmijët	46
Sugjerime	48

# Hyrje

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në kuadër të implementimit të projektit “Ndjekja e rasteve të litigimit strategjik në mbrojtje të të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe grave në raste të divorceve” me mbështetje financiare të United Nations Development Program (UNDP), ka patur në fokus të tij rritjen e aksesit të grave dhe fëmijëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet rasteve të litigimit strategjik / ndihmës ligjore falas, ndryshimeve ligjore, rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin masiv duke përdorur standardet ndërkombëtare.

Forcimi i të drejtave ekonomike të fëmijëve dhe prindërve përgjegjës për mirërritjen dhe edukimin e tyre, bazuar në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt divorci dhe pagimi detyrimi ushqimor nga Zyra e Përmbarrimit ka qenë në fokus të aktiviteteve të vazhdueshme të ndërmarra nga QNL.

Gjatë monitorimit të bërë të vendimeve gjyqësore me objekt “Zgjidhje martese dhe pasojave ekonomike të saj për palët”, për periudhën 2014-2015 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>1</sup>, u vu re një numër tepër i madh vendimeve gjyqësore të paekzekutuara nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë, pasi njëri nga prindërit debitor ndodhej jashtë vendit. Në këtë mënyrë, ekzekutimi gjyqësor nga një mekanizëm shumë i rëndësishëm në përmbushjen dhe realizimin e të drejtës, kthehet në një mjet joefektiv dhe efikas në përmbushje të interesit më të lartë të të miturit.

Në këtë drejtim, u vunë re disa problematika të cilat u bënë pjesë vlerësimeve të raport-analizës sonë. Të tilla përmendim:

- Mungesa e studimeve specifike mbi çështjet që lidhen me (mos)ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës familjare përfshi këtu shlyerjen e detyrimeve ushqimore për fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes dhe implikime e të drejtës ndërkombëtare private;
- Mungesa e të dhënave sasiore dhe cilësore në lidhje me numrin e fëmijëve apo pjesëtarëve të tjerë të familjes që nuk kanë mundur të përfitojnë detyrimin për ushqim në favor të tyre, apo numrit të prindërve debitor që nuk shlyejnë detyrimet ushqimore si pasojë e jetesës së tyre në një shtet tjetër apo që janë në pamundësi ekonomike;

1 [http://www.qag-al.org/publikime/Raporti\\_mbi\\_gjetjet\\_kryesore.pdf](http://www.qag-al.org/publikime/Raporti_mbi_gjetjet_kryesore.pdf)

- Mungesa e të dhënave sasiore dhe cilësore mbi çështjet e ndjekura nga zyra e përmbarimit të cilat janë ende në proces ekzekutimi apo sa prej tyre, çështjeve, janë të pushuara ose të përfunduara me sukses;
- Një tjetër vështirësi ishte mungesa e statistikave/të dhënave specifike mbi forma të tjera të vjeljes së detyrimit për ushqim të fëmijëve, si vullnetarisht ashtu dhe nga institucione të tjera publike, bashkëpunimi me to nga ana e Zyrës së Përmbarimit apo rastet e konfiskimit të pasurive të prindit debitor, etj.

Ekzistenca e një baze me një informacion të tillë do të kishte ndihmuar ekspertët në përpjekjen e tyre për një analizë krahasuese të dhënash dhe identifikimi të problematikave përmes sjelljes së rasteve specifike.

# Metodologjia

Për realizimin e këtij raporti, ekspertët kanë përdorur metodën e analizës ligjore të një dokumenti me rëndësi në fushën e të drejtës ndërkombëtare private siç është, Konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes, ose shprehur shkurt, Konventa e Hagës nr. 38. Kjo analizë e përmbajtjes së konventës dhe zbatimit të saj përmes modeleve krahasuese ofron mundësinë e aplikimit të saj nga profesionistët.

## Metodologjia e përdorur përmban në vetvete disa qasje të tilla si:

- Analiza e kuadrit ligjor shqiptar (Kushtetutë), akte ndërkombëtare (si Konventa e Hagës 2007), ligje, akte nënligjore mbi problematikën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt “detyrimin ushqimor” për fëmijët ose anëtarët e tjerë të familjes;
- Praktika e zbatimit, përmes rasteve të litigimit strategjik, të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve në fushën e njohjes dhe ekzekutimit të detyrimeve ushqimore si një risi në jurisprudencën e deritanishme;
- Identifikimi, diskutimi dhe ndarja e problemeve përmes trajnimeve /seminareve /tryezave të rumbullakëta të zhvilluara me gjyqtarë, përmbarues gjyqësore, avokatë, juristë;
- Mbledhja dhe përpunimi i informacionit mbi situatën e ekzekutimit të detyrimeve ushqimore nga praktika e rasteve të trajtuara pranë QNL-së dhe monitorimit të bërë vendimeve gjyqësore mbi këtë problematikë në vazhdimësi;
- Përgatitja e një drafti me konkluzione dhe sugjerime në proces diskutimi të vazhdueshëm me profesionistë për të kontribuar në përmirësimin e situatës ligjore dhe faktike mbi rritjen e aksesit të fëmijëve dhe nënave në drejtësi për detyrimin ushqimor (90% të raste i lihen nënave fëmijët- burim raporti CEDAW për Shqipërinë)
- Bërja publike e gjetjeve, konkluzioneve dhe sugjerimeve të raportit nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike (media sociale e jo vetëm) për të rritur

ndërgjegjësimin mbi këtë problematikë dhe gjetjen e mekanizmave për të përmirësuar situatën reale.

Të dhënat dhe informacionet e përdorura për realizimin e këtij raport –analize u mundësuan nga shfrytëzimi i literaturës ekzistuese, vendase dhe të huaj. Kjo literaturë (studime, raporte, artikuj të realizuar nga studiues vendas dhe organizata lokale e ndërkombëtare, ligje dhe politika të shtetit shqiptar pas viteve 1990 e në vijim) ka shërbyer për të identifikuar problematikën dhe evidentuar mangësitë në legjislacionin shqiptar, sidomos në drejtim të zbatimit të tij përsa i përket përmbushjes së detyrimit ushqimor nga ana e prindit debitor. Vendosja e informacionit të marrë në nivele paralele krahasimore, nxori në pah dhe evidentoi nevojën për përmirësime në kuadrin ligjor ekzistues, krijimin e mekanizmave të veprimit, standardet ligjore dhe administrative me qëllim realizimin e bashkëpunimi ndër institucional në kuadër të zbatimit të Konventës së Hagës të 2007.



# 1. Njohuri të përgjithshme mbi Konventat e Hagës me objekt detyrimin për ushqim. Çfarë profesionistët duhet të dinë

## 1.1. Konventat e ratifikuara nga Shqipëria me objekt detyrimin për ushqim

Detyrimi për ushqim është garancia për ti siguruar kujtdo që ndodhet në një situatë nevojë një mbështetje të vazhdueshme ose periodike të gjithçkaje që është e nevojshme për të jetuar. Kjo mbështetje është i lidhur ngushtë me kushtet ekonomike të të detyruarit.

Në lidhje me detyrimin për ushqim, institucionet ndërkombëtare, kanë përshkruar një rrugëtim drejt mbrojtjes së përfituesit të detyrimit për ushqim, ose quajtur ndryshe, kreditorit, si pala e dobët e raportit. Kësaj pale i nevojitet një mbrojtje e sigurt dhe e shpejtë duke ofruar instrumente dhe procedura njohjeje të vendimeve jo shumë formale me qëllim garantimin e zgjidhjeve të ngjashme dhe autonome ndaj legjislacioneve kombëtare.

Kuadri ligjor i Konferencës së Hagës, ratifikuar nga Shqipëria, lidhur me detyrimin për ushqim përmbledh:

- **Konventën e Hagës mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore**<sup>2</sup>, [e 2 Tetor 1973 që mban numrin 24].;

2 “Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” bërë në Hagë më 2 tetor 1973. Aderuar më 29.08.2011. Kjo konventë ka hyrë në fuqi më 1 Nëntor 2011.

- **Konventën e Hagës mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore**<sup>3</sup>, [e 2 Tetorit 1973 që mban numrin 23] dhe

**Konventa e Hagës** 'Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes [e 23 Nëntorit 2007 që mban numrin 38]

**VINI RE:**

për tu njohur me gjithë Konventat e Hagës të ratifikuara nga Shqipëria, mund të aksesoni faqen

<https://www.hcch.net/en/states/hcch-members/details1/?sid=18>

Deri në botimin e këtij raporti Shqipëria ka ratifikuar 14 konventa të Hagës.

Këto tri Konventa ruajnë disa nga parimet kryesore të konventave të mëparshme Hagës<sup>4</sup> të cilat gjithashtu kanë efekt mbi çështje të detyrimit për ushqim.

Vëmë re se nuk gjendet një përkufizim shterues i "detyrim për ushqim". Diçka e re është zgjerimi i fushës së veprimit të detyrimit për ushqim në subjekte të tjerë që janë derivat i marrëdhënieve familjare për shkak të lidhjeve të gjakut ose atyre juridike. Përsa i përket caktimit të ligjit të aplikueshëm, Konventa parashikon një sërë lidhjesh të ndërthura që ofrojnë një favorizim maksimal ndaj kreditorit në realizimin e të drejtave të tij lidhur me detyrimin për ushqim.

Ndryshimet midis konventave jepen qartë qysh në titujt e tyre. Për efekt të kuptuarit, në ndonjë rast, nevojitet që profesionistët të drejtohen faqes zyrtare të Konferencës së Hagës ose teksteve në origjinal të konventave.

Ndonëse, fokusi ynë është Konventa 38, po ndalemi shkurtimisht edhe në dy konventat e tjera të ratifikuara dhe që lidhen me detyrimin për ushqim.

3 "Konventa mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore", bërë në Hagë më 2 tetor 1973 Aderuar më 29.08.2011. Kjo konventë ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2011.

4 Konventa e Hagës, 24 Tetor 1956, mbi Ligjin e zbatueshëm për detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve dhe Konventa e Hagës, 15 Prill 1958, mbi Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fushën e detyrimeve martesore ndaj fëmijëve. Këto konventa nuk janë të ratifikuara nga Shqipëria.

## 1.2. “Konventa mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore” [nr. 23]

### Cila është fusha e veprimit të Konventës 23? Neni 1

**Së pari:** duhet të ketë një vendim administrativ ose gjyqësor lidhur me detyrimin për ushqim që është dhënë në një shtet kontraktues të konventës 23; gjithashtu konventa zbatohet edhe kur DU buron nga një marrëveshje e kreditorit dhe debitorit bërë përpara një autoriteti administrativ ose gjyqësor;

**Së dyti:** detyrimi për ushqim buron nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhjeje tjetër jo gjaku. Këtu përfshihet edhe detyrimi për ushqim ndaj një të mituri, të lindur jashtë martese;

**Së treti:** mosmarrëveshjet përfshijnë ato midis:

- përfituesi të detyrimit ushqimor dhe një ofruesi të detyrimit ushqimor; apo
- një ofruesi të detyrimit ushqimor dhe një autoriteti publik, i cili pretendon rimbursimin e fitimeve të dhëna një përfituesi të detyrimit ushqimor.

**A ka rezerva lidhur me këtë fushë veprimi?** Po këto janë të parashikuara në nenin 26 dhe 34, por Shqipëria nuk ka paraqitur ndonjë të tillë.

Kështu sipas nenit 34, shtet kontraktuese, kanë të drejtën për të mos njohur ose zbatuar:

- “një vendim ose marrëveshje në masën që kjo lidhet me një periudhë kohore pasi përfituesi i detyrimit ushqimor arrin moshën 21 vjeç ose martohet, përveç rasteve kur përfituesi është ose ka qenë bashkëshorti i ofruesit të detyrimit ushqimor;
- një vendim ose marrëveshje në lidhje me detyrimet ushqimore ndërmjet: personave me lidhje fafërisnore; personave me lidhje jo gjaku; një vendim ose marrëveshje, nëse nuk parashikon pagesa periodike të detyrimit ushqimor.
- Një shtet kontraktues që ka bërë një rezervë nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e kësaj Konvente për vendime ose marrëveshje të tilla që përjashtohen nga rezerva e tij” (neni 26)<sup>5</sup>

5 Kjo Konventë zëvendëson, për sa u përket shteteve që janë palë në të, Konventën mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve, e lidhur në Hagë më 15 prill 1958.

### 1.3. Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore<sup>6</sup>[nr.24]

Kjo konventë përcakton ligjin e zbatueshëm në rastin e detyrimit për ushqim kur ky i fundit buron nga

- marrëdhënie familjare,
- prindërore,
- martesore apo
- lidhje tjetër jogjaku,
- duke përfshirë edhe një detyrim ushqimor ndaj një të mituri të lindur jashtë martese<sup>7</sup>.

Edhe në këtë Konventë<sup>8</sup>, çdo shtet kontraktues, në përputhje me nenin 24 të saj, mund të rezervojë të drejtën që të zbatojë këtë Konventë vetëm për detyrimet ushqimore ndërmjet:

- bashkëshortëve dhe ish-bashkëshortëve;
- në lidhje me një person që nuk ka arritur moshën e njëzet e një vjeç dhe nuk ka qenë i martuar.

6 Kjo Konventë zëvendëson, në marrëdhëniet midis shteteve që janë palë në të, Konventën mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve, lidhur në Hagë, më 24 tetor 1956. Megjithatë, paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për një shtet që, në bazë të rezervës së parashikuar në nenin 13, ka përjashtuar zbatimin e kësaj Konvente për detyrimet ushqimore në lidhje me një person, i cili nuk ka arritur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk ka qenë i martuar. (Neni 18)

7 Neni 1 i saj Konventa mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore (lidhur më 2 tetor 1973)

8 Neni 13 po aty

## 2. Konventa “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” [nr 38]

---

*“shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura, (...) për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (...) në veçanti kur këta persona jetojnë në shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës”.*

---

Interesi më i mirë i fëmijës ka rëndësi parësore dhe çdo fëmijë ka të drejtën e një standardi të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, 1989 dhe Preambula e Konventës së Hagës, 2007)<sup>9</sup>.

### 2.1. Objekti i Konventës

Kjo konventë, e përfunduar në Hagë më 23 nëntor 2007 është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë<sup>10</sup>, me ligjin Nr. 63/31.5.2012, “Për rivendosjen ndërkombëtare të

9 Vini re: Për më shumë lidhur me kuptimin e kësaj konvente të interesuarit mund të lexojnë raportin shpjegues i cili gjendet në dy gjuhë: anglisht dhe frëngjisht në faqen e Konferencës së Hagës: <https://assets.hcch.net/upload/expl38.pdf>

**Kujdes:** Në këtë faqe gjenden edhe template të mënyrës së aplikimit me qëllim rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit për ushqim.

10 Shpallur me dekretin nr. 7543, datë 15.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”..

Konventa është e ndërtuar në 9 kapituj dhe ka në përbërjen e saj 65 nene dhe 2 shtojca, konkretisht: [1] Formulari i transmetimit sipas nenit 12 (2) njoftim për mbrojtjen e fshehtësisë dhe të dhënave personale (shtojca 1) dhe [2] shtojca 2 e cila përcakton formularin e transmetimit të informacionit konform nenit 12 (3).

Qëllimi i Konventës është që midis shteteve nënshkruese të **garantohet mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të grave, pjesëtare të familjes, duke përcaktuar rregullat dhe kriteret për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë detyrim ushqimor apo forma të tjera të mbështetjes financiare.**

Kjo konventë vë në dukje **karakterin e saj ndërkombëtar dhe nevojën për të nxitur një zbatim uniform** të saj. **Konventa reflekton** dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve, për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimeve ushqimore ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes si dhe nevojën për procedura që sjellin rezultate të arritshme, të shpejta, efektive, ekonomike, të hapura dhe të drejta midis palëve. Konventa mbështetet në elementet më të mira të konventave ekzistuese të Hagës dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, në veçanti Konventën e Kombeve të Bashkuara për rivendosjen jashtë shtetit të detyrimeve ushqimore të 20 qershorit 1956 [jo e ratifikuar nga vendi ynë], si dhe në **përparimet në teknologjinë** transferimin e fondeve duke kërkuar **të krijojë një sistem fleksibël** që mund të vazhdojë të evoluojë, ndërkohë që nevojat ndryshojnë dhe përparime të mëtejshme në teknologji krijojnë mundësi të reja.

Konventa mbështetet **në garantimin e interesit më të lartë të fëmijës**; në të drejtën e çdo fëmije të një standardi jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social; në detyrimin e prindit ose personave të tjerë përgjegjës për fëmijën për të siguruar, brenda mundësive dhe kapaciteteve të tyre financiare, kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës; si dhe detyrimin e shteteve palë që të marrin të gjitha masat e duhura, për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (prindërit) ose persona të tjerë përgjegjës, në veçanti kur këta persona jetojnë në një shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës.

Objekti i kësaj Konvente është garantimi i rivendosjes efektive ndërkombëtare të detyrimeve ushqimore dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e familjes, veçanërisht nëpërmjet:

- krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të shteteve kontraktuese;
- vënies në dispozicion të kërkesave për marrjen e vendimeve për detyrime ushqimore;
- parashikimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve për detyrime ushqimore; dhe
- kërkit të masave efektive për zbatimin e shpejtë të vendimeve për detyrimin ushqimor.

## 2.2. Fusha e zbatimit

### Ku i shtrin efektet Konventa 38?

Konventa i shtrin efektet në lidhje me:

- detyrimet ushqimore që lindin nga marrëdhënia prind-fëmijë ndaj një personi nën moshën 21 vjeç;
- njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi për mbështetje bashkëshortore; Republika e Shqipërisë në instrumentin e ratifikimit, nenin 2 të tij, deklaron, në përputhje me nenin 2 (3), të drejtën për të përcaktuar, njohur dhe zbatuar detyrimet për mbështetjen financiare, që lindin nga një marrëdhënie martesore në të njëjtën masë me detyrimet që lidhen me mbështetjen e fëmijës, sipas kapitullit II dhe III të konventës, dhe
- mbështetjen bashkëshortore [me përjashtimin e sa parashikohet në kapitujt II dhe III të saj].



#### KUJDES:

Republika e Shqipërisë në instrumentin e ratifikimit, nenin 3 të tij, deklaron, në përputhje me nenin 2 (3) të Konventës, të drejtën për të zbatuar detyrimin ushqimor edhe për fëmijët madhorë deri në moshën njëzet e pesë vjeç, me kusht që ata të ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, sipas parashikimeve të nenit 197 të Kodit të Familjes;



#### VINI RE:

##### Vini re: rëndësia e leximit të rezervave lidhur me Konventën

Leximi i rezervës ka shumë rëndësi për juristët për të parë se çfarë drejtimi zgjerues ose më të ngushtë i ka dhënë shteti i vet ose shteti tjetër kontraktues me të cilin po zgjidhen mosmarrëveshje në fushën e zbatimit të konventës. Kështu, p.sh, Konventa parashikon që çdo shtet nënshkruar mund të rezervojë të drejtën për të parashkruar zbatimin e Konventës për personat, të cilët nuk kanë arritur moshën 18 vjeç. Në këtë rast shteti kontraktues, që bën këtë rezervë, nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e Konventës për persona në moshën që përjashtohet nga rezerva e tij.

Shtetet do të zbatojnë të gjithë ose një pjesë të Konventës për çdo detyrim mbi mbështetjen financiare që lind nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore ose lidhjeje të afërt, duke përfshirë në veçanti detyrimet në lidhje me personat në nevojë, kjo në përputhje me përmbushjen e detyrimeve ndërmjet dy shteteve kontraktuese vetëm në atë masë që deklaratat e tyre mbulojnë të njëjtat detyrime të mbështetjes financiare dhe pjesë të Konventës.

## 2.3. Kriteret e kompetencës: autoriteti qendror

Konventa bazohet në krijimin e një rrjeti autoritetesh publike/administrative ndërkombëtare bashkëpunuese midis tyre [shih kreu II]. Në bazë të Konventës çdo shtet kontraktues duhet të caktojë një autoritet qendror për të përmbushur detyrat që vendosen nga Konventa për këtë autoritet (neni 4 Konventës). Janë këto autoritete që duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të nxisin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente në shtetet e tyre për të arritur qëllimet e Kon-

ventës apo për të kërkuar zgjidhjet më të mundshme ndaj vështirësive që lindin në zbatim të Konventës (neni 5 Konventës).

Në rastin e Shqipërisë, autoriteti vendas është Ministria e Drejtësisë. Për të parë se cilat janë shtetet që e kanë ratifikuar konventën dhe autoritetet e tyre mund të përdoret ky link: <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/authorities1/?cid=131>

## 2.4. Detyrimet për shtetet nënshkruese

Çfarë parashikohet të ndërmarrin shtetet kontraktuese dhe autoritetet e tyre përgjegjëse? Sipas konventës, këtu hyjnë:

- shqyrtimi dhe transmetimi i kërkesave të paraqitura në përputhje me Konventën;
- ndihma në përcaktimin e vendndodhjes së debitorit ose kreditorit;
- ndihma në marrjen e informacionit përkatës në lidhje me të ardhurat dhe rrethanat e tjera financiare të debitorit ose kreditorit;
- nxitja e zgjidhjes miqësore, me synim pagesën vullnetare të detyrimit ushqimor;
- lehtësimi në mbledhjen dhe transferimin e përshpejtuar të pagesave të detyrimit ushqimor;
- lehtësimi në marrjen e provave dokumentuese ose provave të tjera etj<sup>11</sup>.

### Kush i paguan shpenzimet?

Në bazë të Konventës [neni 8] shpenzimet e autoritetit qendror do të përballohen nga buxheti i vetë autoritetit duke mos vendosur detyrime financiare ndaj një kërkuesi për ofrimin e shërbimeve të tyre sipas Konventës. Bëjnë përjashtim shpenzimeve që mund të lindin nga një kërkesë për një masë specifike. Se cilat janë këto masa specifike, përcaktohen në nenin 7 që, në fakt, është një dispozitë referuese tek neni 6 Konventës. Të tilla janë:

- për të ndihmuar në përcaktimin e vendndodhjes së debitorit ose kreditorit;
- për të ndihmuar në marrjen e informacionit përkatës në lidhje me të ardhurat dhe, nëse është e nevojshme, rrethanat e tjera financiare të debitorit ose kreditorit, duke përfshirë përcaktimin e vendndodhjes së asetëve të tyre;
- për të lehtësuar marrjen e provave dokumentuese ose provave të tjera;
- për të siguruar ndihmë në përcaktimin e përgjegjësisë prindërore, kur është e nevojshme, për rivendosjen e detyrimit ushqimor;
- për të filluar ose lehtësuar fillimin e procedimeve për marrjen e çdo mase të nevojshme të përkohshme, që kanë karakter territorial dhe qëllimi i të cilave është garantimi i rezultatit të një kërkesë për detyrim ushqimor ende të papërfunduar;
- për të lehtësuar dërgimin e dokumenteve.

11 Neni 6 i Konventës.



## **Cilat janë rregullat procedurale për paraqitjen e kërkesës, përcjelljen, dhe komunikimin mes autoriteteve qendrore të dy shteteve?**

Kërkesa mund të bëhet nëpërmjet autoritetit qendror të shtetit kontraktues në të cilin banon kërkuesi, për autoritetin qendror të shtetit të kërkuar ku ndodhet debitori kundër të cilit ka një vendim ekzistues për detyrim ushqimor (Neni 9-10 i Konventës). Konventa përcakton përmbajtjen dhe llojet e kërkesave që mund të paraqiten sipas saj, përkatësisht nga kreditori apo debitori, në lidhje me rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor apo forma të tjera të mbështetjes financiare ndërmjet anëtarëve të familjes. Këto kërkesa kanë të bëjnë kryesisht me njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi në shtetin e kërkuar, zbatimin e një vendimi të marrë ose të njohur në shtetin e kërkuar, apo ndryshimin e një vendimi të marrë në shtetin e kërkuar ose në një shtet të ndryshëm nga shteti i kërkuar<sup>12</sup>. Sipas Konventës është autoriteti qendror i shtetit kërkuar që ndihmon kërkuarin për të plotësuar kërkesën me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe që kur çmon se kërkesa pajtohet me kërkesat e Konventës, transmeton kërkesën në emër të dhe me pëlqimin e autoritetit qendror të shtetit të kërkuar.

### **A ka afate?**

Autoriteti qendror i kërkuar, brenda gjashtë javësh nga data e marrjes së kërkesës, konfirmon marrjen dhe informon autoritetin qendror të shtetit kërkuar se cilët hapa fillestarë janë marrë ose do të merren për trajtimin e kërkesës, dhe mund të kërkojë çdo dokument dhe informacion tjetër të nevojshëm. Po brenda gjashtë javëve, autoriteti qendror i kërkuar i jep autoritetit qendror kërkuar emrin dhe informacionet e kontaktit të personit ose njësisë përgjegjëse për përgjigjen ndaj kërtimeve në lidhje me ecurinë e kërkesës. Brenda tre muajve pas konfirmimit, autoriteti qendror i kërkuar informon autoritetin qendror kërkuar për statusin e kërkesës.

### **Cilat janë mjetet e komunikimit midis autoriteteve dhe gjuha e komunikimit?**

Mjetet e komunikimit janë ato më të shpejta dhe efektive në dispozicion të tyre. Sipas *Konventës* kërkesa dhe dokumentet e ngjashme bëhen në gjuhën origjinale dhe shoqërohen nga një përkthim në gjuhën zyrtare të shtetit të kërkuar ose në një gjuhë tjetër që shteti i kërkuar ka përcaktuar, me anë të një deklaratë në përputhje me nenin 63 që ai do të zbatohet, nëse autoriteti kompetent i atij shteti nuk përjashton përkthimin. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga autoritetet qendrore, çdo komunikim tjetër ndërmjet këtyre autoriteteve do të jetë në një gjuhë zyrtare të shtetit të kërkuar ose në anglisht ose frëngjisht. Shpenzimet e përkthimit do të përballohen nga shteti kërkuar nëse nuk bihet dakord ndryshe nga autoritetet qendrore të shteteve përkatëse.

12 Neni 11 i Konventës

## E drejta e aksesit në procedura, ndihmë ligjore, etj

Konventa u garanton kërkuesve akses efektiv në procedura, duke përfshirë procedurat e aplikimit dhe të ekzekutimit, duke u siguruar atyre ndihmë ligjore falas (neni 14 Konventës), ndihmë e cila garantohet gjithashtu edhe ndaj kërkesave të mbështetjes ndaj fëmijës, konkretisht atij nën moshën 21 vjeç. Por mbahet parasysh që shteti i kërkuar mund të refuzojë ndihmën ligjore falas nëse çmon se, në themel, kërkesa ose apeli është haptazi e/i pabazuar (neni 15 Konventës). Sipas Konventës ndihma ligjore falas mund t'i nënshtrohet një testi mjetesh ose meritash dhe në rastin kur një kërkues, i cili në shtetin e origjinës ka përfituar nga ndihma ligjore falas, ka të drejtë në çdo procedim për njohje ose zbatim, të përfitojë, të paktën në të njëjtën masë, nga ndihma ligjore falas e parashikuar me ligjin e shtetit të adresuar, sipas rrethanave të njëjta.

Sipas kapitullit IV **kufizimet e procedimeve** kanë gjithmonë lidhje më vendbanimin e zakonshëm të palëve (kreditorit), kufizim i cili nuk zbatohet në rastet e mosmarrëveshjeve mbi detyrimet ushqimore në lidhje me fëmijët, kur ka marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve të juridiksionit të atij shteti tjetër kontraktues; kur kreditori i nënshtrohet juridiksionit të atij shteti tjetër kontraktues; kur autoriteti kompetent në shtetin e origjinës nuk mund ose refuzon të ushtrojë juridiksion për të ndryshuar vendimin ose për të marrë një vendim të ri; ose kur vendimi i marrë në shtetin e origjinës nuk mund të njihet ose shpallet i ekzekutueshëm në shtetin kontraktues ku shqyrtohen procedimet për ndryshimin e vendimit ose për marrjen e një vendimi të ri.

## 2.5. Rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që përmbajnë detyrimin për ushqim apo forma të tjera të mbështetjes financiare ndaj anëtarëve të familjes

Konventa i parashikon këto në një kapitull të posaçëm (Kapitulli V) dhe përcakton rastet kur:

- vendimi duhet të njihet, apo në të kundërt të refuzohet, nga autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

Termi "vendim" përfshin:

- një vendim të dhënë nga një autoritet gjyqësor ose administrativ në lidhje me një detyrim ushqimor;
- një kontratë ose marrëveshje të lidhur më parë ose të miratuar nga ky autoritet;
- një rregullim automatik me anë të indeksimit dhe një kërkesë për të paguar shumat e prapambetura, mbështetjen financiare ose interesin prapaveprues dhe një përcaktim të kostove ose shpenzimeve.

“Autoriteti administrativ” nënkupton, sipas kësaj Konvente, një organ publik vendimet e të cilit, sipas ligjit të shtetit ku është krijuar:

- a) mund t'i nënshtrohen një apeli ose rishikimi nga një autoritet gjyqësor;
- b) kanë një fuqi dhe efekt të ngjashëm me një vendim të një autoriteti gjyqësor për të njëjtën çështje.

### **Cilat janë bazat për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve?**

Këto mbështeten mbi vendime të dhëna nga autoritete gjyqësore ose administrative në lidhje me një detyrim ushqimor në të gjitha ato raste kur:

- i padituri / kreditori ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet;
- fëmija për të cilin është urdhëruar detyrimi ushqimor ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet, me kusht që i padituri të ketë jetuar me fëmijën në atë shtet ose të ketë banuar në atë shtet dhe të ketë ofruar mbështetje për fëmijën atje;
- përveç rasteve të mosmarrëveshjeve mbi detyrimet e mbështetjes financiare në lidhje me fëmijët, ka pasur marrëveshje me shkrim për juridiksionin nga palët; ose
- vendimi është marrë nga një autoritet që ushtron juridiksion për një çështje me status personal ose përgjegjësi prindërore, nëse juridiksioni nuk është bazuar vetëm në kombësinë e një prej palëve.

### **A shqyrtohet themeli i çështjes?**

Jo. Konventa thekson se autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar nuk mund të shqyrtojë themelin e vendimit të marrë nga autoriteti përkatës i shtetit të origjinës. Pra, **një vendim njihet vetëm nëse ka fuqi në shtetin e origjinës dhe ekzekutohet vetëm nëse është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës** (Neni 20 Konventës). Gjithashtu, autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar është i detyruar nga përfundimet e fakteve në të cilat autoriteti i shtetit të origjinës ka bazuar juridiksionin e tij (Neni 27 i Konventës). Në rastin ku **shteti** i adresuar nuk është i aftë të njohë ose zbatojë të gjithë vendimin, ai do të njohë ose zbatojë çdo pjesë të veçantë të vendimit që mund të njihet ose zbatohet në këtë mënyrë, procedurë e cila mund të kërkohet në çdo rast.

Cilat janë rastet kur njohja dhe ekzekutimi i një vendimi mund të refuzohen? Këto përfshijnë:

- papajtueshmërinë haptazi me politikën publike (ordre public) të shtetit të adresuar;
- marrjen e vendimit me anë të mashtrimit në lidhje me një çështje procedurale;
- procedimet e mbetura pezull midis palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim para një autoriteti të shtetit të adresuar dhe këto procedime kishin filluar më parë;

- papajtueshmërinë e vendimit me një vendim të dhënë midis palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim, ose në shtetin e adresuar ose në një shtet tjetër, me kusht që ky vendim i fundit të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen dhe zbatimin e tij në shtetin e adresuar;
- rastin kur i padituri nuk është paraqitur dhe as nuk është përfaqësuar në procedime në shtetin e origjinës: ligjin e shtetit të origjinës që parashikon njoftimin e procedimeve, kur i padituri nuk ishte njoftuar për procedimet dhe nuk kishte mundësi për t'u dëgjuar; ose kur ligji i shtetit të origjinës nuk parashikon njoftimin e procedimeve, i padituri nuk ishte njoftuar për vendimin dhe nuk kishte mundësi për ta kundërshtuar ose apeluar atë në bazë të fakteve dhe ligjit;
- vendimi është marrë në shkelje të nenit 18 mbi kufizimet e njohjes ose ekzekutimit të vendimeve.

Neni 23 i kësaj Konvente përcakton që ekzekutimi i vendimit kryhet në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar, nëpërmjet autoriteteve qendrore të tij. Në rastin e paraqitjes së një kërkesë për mospranim ose apel në bazë të fakteve dhe një argument ligjor, ajo duhet të depozitohet brenda 30 ditëve nga njoftimi, dhe kur pala kundërshtuese nuk është rezidente në shtetin kontraktues në të cilin është bërë ose refuzuar deklarata ose regjistrimi, kërkesa për mospranim ose apel do të paraqitet brenda 60 ditëve nga njoftimi. Sipas Konventës në marrjen e një vendimi për njohjen dhe zbatimin, duke përfshirë çdo apel, autoriteti kompetent vepron me shpejtësi.

Me çfarë shoqërohet kërkesa për njohje dhe ekzekutim? Të tilla janë:

- një tekst të plotë të vendimit;
- një dokument që deklaron se vendimi është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës dhe, në rast të një vendimi nga një autoritet administrativ, një dokument që deklaron se kërkesat e nenit 19(3) janë përmbushur, nëse ai shtet nuk ka përcaktuar në përputhje me nenin 57 se vendimet e autoriteteve të tij administrative plotësojnë këto kërkesa në çdo rast;
- nëse i padituri nuk është paraqitur dhe nuk është përfaqësuar në procedimet gjyqësore në shtetin e origjinës, një dokument ose dokumente që vërtetojnë, sipas rastit, se i padituri është njoftuar për procedimet gjyqësore dhe ka pasur mundësi për t'u dëgjuar, ose se i padituri është njoftuar për vendimin dhe ka pasur mundësinë për ta kundërshtuar ose apeluar atë në bazë të fakteve dhe ligjit;
- kur është e nevojshme, një dokument që tregon shumën e pagesave të prapambetura dhe datën kur kjo shumë është llogaritur;
- kur është e nevojshme, në rastin e një vendimi që parashikon rregullimin e menjëhershëm me indeksim, një dokument që ofron informacionin e nevojshëm për bërjen e llogarive të duhura;
- kur është e nevojshme, dokumentacion që tregon masën në të cilën kërkuesi ka marrë ndihmë ligjore falas në shtetin e origjinës. Në rastin e një kërkesë për mospranim ose apel, me kërkesën e autoritetit kompetent në shtetin e adresuar, një kopje e plotë e dokumentit përkatës, e vërtetuar nga autoriteti kompetent në shtetin e origjinës, sigurohet menjëherë: a) nga autoriteti qen-

dror i shtetit kërkues, kur kërkesa është bërë në përputhje me kapitullin III; b) nga kërkuesi, kur kërkesa i është bërë drejtpërdrejt një autoriteti kompetent të shtetit të adresuar.

Procedura e kërkesës për njohje bazohet mbi principin *mutatis mutandis* ndaj një kërkesë për njohjen e një vendimi, përveç rasteve kur kërkesa e ekzekutueshmërisë zëvendësohet nga kërkesa që vendimi ka fuqi në shtetin e origjinës (Neni 26 i Konventës). Konventa përcakton që prania fizike e fëmijës ose e kërkuesit nuk kërkohet në çdo procedim gjyqësor në shtetin e adresuar.

## 2.6. Rregullat për njohjen dhe ekzekutimin e marrëveshjeve që përmbajnë detyrimin për ushqim

Siç u përmend, krahas vendimeve gjyqësore, objekt tjetër i procedurës së njohjes dhe ekzekutimit janë dhe marrëveshjet për detyrim ushqimor, të bëra në një shtet kontraktues, me kusht që ajo të jetë e ekzekutueshme në vendin e shtetit të origjinës.

Cilat janë dokumentet që shoqërojnë kërkesën për njohje dhe ekzekutim të marrëveshjes për detyrim për ushqim? Të tilla janë:

- teksti i plotë i marrëveshjes së detyrimit ushqimor; dhe
- një dokument që deklaron se marrëveshja e veçantë e detyrimit ushqimor është e ekzekutueshme si vendim në shtetin e origjinës.

A mund të refuzohet njohja dhe ekzekutimi i marrëveshjes për detyrim ushqimor? Po, shkaqet e mundshme përshijnë:

- njohja dhe ekzekutimi janë haptazi të papajtueshme me politikat publike të shtetit të adresuar;
- marrëveshja e detyrimit ushqimor është realizuar me anë të mashtrimit ose falsifikimit;
- marrëveshja e detyrimit ushqimor nuk pajtohet me një vendim të dhënë ndërmjet palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim, ose në shtetin e adresuar ose në një shtet tjetër, me kusht që ky vendim i fundit të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen dhe zbatimin e tij në shtetin e adresuar.

Procedimet për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje për mbështetjen financiare do të pezullohen nëse një kërkesë për mospranim në lidhje me marrëveshjen ka mbetur pezull para një autoriteti kompetent të një shteti kontraktues. Ashtu si dhe për vendimet gjyqësore, kërkesat për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje për mbështetje financiare bëhen vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore të shtetit nënshkrues të Konventës. Por, një shtet kontraktues, në përputhje me nenin 62, mund të rezervojë të drejtën për të mos njohur dhe zbatuar një marrëveshje për mbështetjen financiare<sup>13</sup>.

13 Neni 30 i Konventës

## 2.7. Situata kur 2 shtetet janë 'shtete origjine'

Në përmbajtjen e saj Konventa i ofron një përcaktim edhe procedurës që ndiqet në rastet e vendimeve të marra nga *efekti i kombinuar i urdhrave të përkohshëm të marrë në një shtet dhe të një urdhri nga një autoritet në një shtet tjetër* (shteti konfirmues), që konfirmon urdhrin e përkohshëm. Në këtë rast secili prej këtyre shteteve konsiderohet, të jetë një shtet origjine; kërkesat e nenit 22 "e" të Konventës do të përmbushen nëse i padituri është njoftuar për procedimet në shtetin konfirmues dhe ka pasur një mundësi për të kundërshtuar konfirmimin e urdhrin të përkohshëm; kërkesa e nenit 20(6), që një vendim të jetë i zbatueshëm në shtetin e origjinës, do të përmbushet nëse vendimi është i zbatueshëm në shtetin konfirmues; dhe kushtet kur neni 18 nuk pengon procedimet për ndryshimin e vendimit që fillojnë në çdo shtet<sup>14</sup>.

Një kapitull shumë i rëndësishëm i konventës është edhe ai që përcakton **procedurën e ekzekutimit të vendimit nga shteti i adresuar**, në bazë të kërkesës së paraqitur nga shteti i origjinës. Ekzekutimi në këtë rast kryhet në përputhje me ligjin e shtetit të adresuar dhe është i menjëhershëm. Mjafton që kërkesa e paraqitur nëpërmjet autoriteteve qendrore, të mbështetet mbi një vendim të shpallur të ekzekutueshëm ose të regjistruar për ekzekutim dhe ekzekutimi të vijojë pa nevojën për veprime të mëtejshëm nga kërkuesi. Çdo rregull i zbatueshëm në shtetin e origjinës për vendimin në lidhje me kohëzgjatjen e detyrimit ushqimor, merr fuqi ligjore. Në rastin e parashkrimit të periudhës për të cilën mund të zbatohen pagesat e prapambetura, ato përcaktohen ose nga ligji i shtetit të origjinës së vendimit, ose nga ligji i shtetit të adresuar, të atij shteti që parashikon periudhën më të gjatë të parashkrimit<sup>15</sup>.

## 2.8. Parimi i mosdiskriminimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Konventa përcakton **parimin e mosdiskriminimit** si parim themelor për ekzekutimin e vendimeve të njohura sipas saj (Neni 33 i Konventës). Në kuadër të këtij parimi, çdo shtet i adresuar duhet të ofrojë minimalisht të njëjtat metoda ekzekutimi për çështjet sipas Konventës, të cilat janë të zbatueshme dhe për çështjet që rregullohen nga legjislacioni i brendshëm. Shtetet kontraktuese duhet të vënë në dispozicion në ligjin e tyre të brendshëm masa efektive për ekzekutimin e vendimeve sipas kësaj Konvente, masa të cilat mund të përfshijnë: mbajtjen nga paga, konfiskimin e pasurisë së një personi të tretë nga llogaritë bankare dhe burime të tjera, zbritjet nga pagesat e sigurimeve shoqërore, barrën mbi ose shitjen e detyruar të pronës etj<sup>16</sup>.

14 Neni 31 i Konventës

15 Neni 32 i Konventës

16 Neni 34 i Konventës: Shtetet kontraktuese vënë në dispozicion në ligjin e brendshëm masa

Konventa kujdeset në **garantimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura ose të transmetuara**, të cilat do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur ose transmetuar apo në mbrojtjen e fshehtësisë së çdo informacioni të përpunuar nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me ligjin e atij shteti. Kjo fshehtësi informacioni duhet të garantohet dhe të mos rrezikohet shëndetin, sigurinë ose lirinë e një personi. Një parashikim për këtë qëllim i cili është bërë nga një autoritet qendror merret në konsideratë nga autoriteti tjetër qendror, veçanërisht në rastet e dhunës në familje.

## 2.9. Organi publik në rolin e kërkuesit

Konventa si pjesë të veçantë të saj ka përcaktuar dhe rastet kur janë *organet publike në rolin e një kërkuesi, “kreditor”, që vepron në vend të një individi*, i cili duhet të përfitojë detyrim ushqimor ose detyrohet të përfitojë rimbursim për përfitimet e realizuara në vend të detyrimit ushqimor.

Organi publik i cili vepron në vend të një individi, që gëzon të drejtën për detyrim ushqimor ose për të kërkuar rimbursim të përfitimeve të dhëna kreditorit në vend të detyrimit ushqimor, vepron në bazë të tagrave të dhëna nga ligji, të cilit i nënshtrohet organi. Ky organ mund të kërkojë njohjen ose të pretendojë zbatimin e: a) një vendimi të dhënë kundër një debitori, me kërkesën e një organi publik që pretendon pagesën e përfitimeve të dhëna në vend të detyrimit ushqimor; b) një vendim të dhënë ndërmjet një kreditori dhe debitori në masën e përfitimeve të dhëna kreditorit në vend të detyrimit ushqimor. Në rastin kur organi publik kërkon njohjen ose pretendon ekzekutimin e një vendimi, me kërkesë, siguron çdo dokument të nevojshëm për të vendosur të drejtën e tij dhe përfitimet t'i jenë dhënë kreditorit. Nëse autoriteti qendror i shtetit të kërkuar vepron në emrin e kërkuesit/es, mund të kërkojë një prokurë nga ai/ajo, për proceset gjyqësore ose para autoriteteve të tjera, ose me qëllim për të caktimin e një përfaqësuesi për të vepruar në këtë mënyrë.

## 2.10. Kërkesa të drejtpërdrejta ndaj autoriteteve kompetente dhe shtete me disa juridiksione. Raporti me konventat e tjera

Çështja e kërkesave të drejtpërdrejta përfshihet në kapitullin e tetë. Të tilla janë, rasti i mundësisë për rekurs ndaj procedurave të vlefshme, sipas ligjit të brendshëm

---

efektive për ekzekutimin e vendimeve sipas kësaj Konvente. Këto masa mund të përfshijnë: a) mbajtjen nga paga; b) konfiskim i pasurisë së një personi të tretë nga llogaritë bankare dhe burime të tjera; c) zbritjet nga pagesat e sigurimeve shoqërore; d) barrën mbi ose shitjen e detyruar të pronës; e) ndalesën në rimbursimin e taksave; f) ndalesën ose konfiskimin e përfitimeve të pensionit; g) raportimin në zyrën e kredisë; h) mohimin, pezullimin ose anulimin e licencave të ndryshme (për shembull, lejet e drejtimit të mjetit); i) përdorimin e ndërmjetësisimit, pajtimit ose proceseve të ngjashme me qëllimin e pajtueshmërisë vullnetare.

të një shteti kontraktues, që i lejon një personi (kërkuesi) t'i drejtohet drejtpërdrejt një autoriteti kompetent të atij shteti në një çështje të rregulluar nga Konventa, duke përfshirë kërkesat e bëra në bazë të nenit 18, për qëllim të marrjes ose ndryshimit të një vendimi për detyrim ushqimor. Ose zbatimi i një vendimi që njeh detyrimet ushqimore e një personi në nevojë mbi moshën e përcaktuar, atë nën 21 vjeç, nëse ky vendim ishte marrë para se personi të arrinte këtë moshë dhe parashikonte detyrim ushqimor, përtej asaj moshe për shkak të dëmtimit.

Konventa parashikon edhe rastet e shteteve të cilët kanë në përbërjen e tyre, dy ose më shumë sisteme ligjore ose grupe rregullash ligjore në lidhje me çështjet objekt i saj, duke vënë theksin në interpretimin/zbatimin e tyre sipas ligjit ose procedurës në fuqi në njësinë përkatëse territoriale; etj<sup>17</sup>. Në rastet e sistemeve ligjore të paunifikuara (një shtet kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore), nuk parashikohet detyrimi ligjor për zbatimin e kësaj Konvente apo njohjen ose zbatimin e një vendimi nga një shtet tjetër kontraktues vetëm sepse vendimi është njohur ose zbatuar në një njësi tjetër territoriale të të njëjtit shtet kontraktues sipas kësaj Konvente<sup>18</sup>.

Kujdes, është me shumë rëndësi për profesionistët: Kjo Konventë zëvendëson Konventën e Hagës të 2 tetorit 1973 për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore dhe Konventën e Hagës të 15 prillit 1958 në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të detyrimeve ushqimore ndaj fëmijëve, në masën që fusha e tyre e zbatimit si ndërmjet këtyre shteteve korrespondon me fushën e zbatimit të kësaj Konvente. Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve kontraktuese, kjo Konventë zëvendëson Konventën e Kombeve të Bashkuara për rivendosjen jashtë shtetit të detyrimeve ushqimore të 20 qershorit 1956, si dhe nuk cenon Konventën e Hagës të 1 marsit 1954 mbi procedurën civile, Konventën e Hagës të 15 nëntorit 1965 mbi dërgimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile ose tregtare dhe konventën e Hagës të 18 marsit 1970 mbi marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare. Sipas saj, çdo shtet kontraktues mund të lidhë me një ose më shumë shtete kontraktuese marrëveshje që përmbajnë dispozita për çështjet e rregulluara nga Konventa, me synim përmirësimin e zbatimit të Konventës ndërmjet ose midis tyre, me kusht që këto marrëveshje të pajtohen me objektin dhe qëllimin e Konventës dhe të mos cenojnë, në marrëdhënien e këtyre shteteve me shtetet të tjera kontraktuese, zbatimin e dispozitave të Konventës. Shtetet që kanë lidhur këtë marrëveshje i transmetojnë një kopje depozitarit të Konventës. Kjo Konventë nuk pengon zbatimin e një marrëveshjeje, mase ose instrumenti ndërkombëtar në fuqi ndërmjet shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar, ose një marrëveshjeje reciprociteti në fuqi në shtetin e kërkuar, që parashikon: a) baza më të gjera për njohjen e vendimeve të detyrimeve ushqimore, pa cenuar nenin 22 "f" të Konventës; b) procedura të thjeshtuara, më të shpejta për një kërkesë për njohje ose ekzekutim dhe ekzekutimin e vendimeve të detyrimit ushqimor; c) ndihmë ligjore më të dobishme sesa ajo e parashikuar sipas neneve 14 deri 17; ose d) procedura

17 Neni 46 i Konventës.

18 Neni 47 i Konventës.



që i lejojnë një kërkuesi nga një shtet kërkues t'i bëjë një kërkesë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, për sa i përket procedurave të thjeshtuara, më të shpejta, ato duhet të pajtohen me mbrojtjen e ofruar palëve sipas neneve të Konventës duke respektuar të drejtat e palëve që të njoftohen për procedurat dhe t'u jepet mundësi e mjaftueshme për t'u dëgjuar dhe për efektet e çdo kundërshtimi ose apelimi.

## 2.11. Çështje praktike me rëndësi

Konform kësaj Konvente, shteti shqiptar deklaron<sup>19</sup>:

- a) të drejtën për të përcaktuar, njohur dhe zbatuar detyrimet për mbështetjen financiare, që lindin nga një marrëdhënie martesore në të njëjtën masë me detyrimet që lidhen me mbështetjen e fëmijës, sipas kapitullit II dhe III të Konventës;
- b) të drejtën për të zbatuar detyrimin ushqimor edhe për fëmijët madhorë deri në moshën njëzet e pesë vjeç, me kusht që ata të ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, sipas nenit 197 të Kodit të Familjes;
- c) se kërkesat për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje për mbështetje financiare bëhen nëpërmjet autoritetit qendror<sup>20</sup>.

Disa nga hapat konkrete:

1. Kërkuesi shqiptar, kreditori, në kuadër të respektimit dhe shfrytëzimit të mjeteve juridike të ofruar nga kjo Konventë, i kërkon me anë të një kërkesë për njohje dhe ekzekutim vendimi të detyrimit për ushqim, autoritetit kompetent përgjegjës shqiptar, transmetimin e kërkesës autoritetit kompetent përgjegjës në shtetin ku ndodhet debitori.
2. Kërkesa lidhur me zbatimin e vendimit duhet të depozitohet në Gjykatën Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, dhe më tej autoritetet gjyqësore të Palëve Kontraktuese do të komunikojnë midis tyre, për qëllimet e ndihmës juridike të ndërsjellë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, me anë të organeve të tyre qendrore. Pra gjykata komunikon përmes Ministrisë së Drejtësisë që në rastin e vendit tonë është autoriteti qendror. Web site i Konferencës së Hagës përmban listën e autoriteteve edhe për vendet e tjera kontraktuese. Sipas nenit 63, Shqipëria është shprehur se kërkesa për njohje dhe zbatimin e vendimit të DU bëhet përmes autoritetit qendror.

Sipas jurisprudencës kushtetuese shqiptare, nga Gjykata është konstatuar fakti se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm

19 Ligji nr. 63/2012 për Ratifikimin e Konventës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”.

20 Në përputhje me nenin 63 të Konventës.

vendimarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 04.03.2010*).

**A mund të jetë një çështje ekzekutimi me elementë të huaj, veprimtaria e përmbarrimit?** Jo. Nisur nga detyrimet që Titulli IV i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë i njeh Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor, si dhe detyrat e përcaktuara në ligjin nr. 8730/18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor" për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv të njohur si të tillë nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, Gjykata vëren se *ky autoritet nuk ka tagrin ligjor të ndjekë procedurat e ekzekutimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë*. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese ndalet në evidentimin e rolit të Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet qendror, në përmbushje të angazhimeve që shteti shqiptar ka ndërmarrë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Në kuadër të Konventës së Hagës për detyrimet ushqimore, Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror, i cili ngarkohet me detyra konkrete në kuadër të zbatimit të dispozitave të saj. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese<sup>21</sup> eidenton faktin se: *"...ky organ, edhe pse nuk mund të investohej drejtpërdrejt nga kërkuesi/kërkuesja në procesin e nisjes së një procedure për njohje dhe zbatim vendimi gjyqësor në territorin grek, nëpërmjet ekspertizës dhe praktikës që kjo ministri ndjek në zbatim e kësaj konvente, ka të gjitha mundësitë për të orientuar drejt kërkuesen/in mbi bazën ligjore të përshtatshme, të zbatueshme në secilin rast, si dhe hapat që duhej të ndërmerre pala kërkuese për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin tjetër...".* Pra, referuar detyrimeve të mësipërme, në funksion të mbrojtjes së interesit të fëmijës, i cili përbën edhe një interes publik, autoritetet shtetërore duhet të bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore të huaja për të zgjidhur çështje që kanë të bëjnë me interesat e fëmijëve. Në këtë kuadër, roli i Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet shtetëror kompetent që transmeton kërkesat për njohje dhe ekzekutim vendimi jashtë territorit shqiptar, është i rëndësishëm si për fillimin e procedurave përkatëse apo lehtësimin e tyre ashtu edhe për marrjen e masave të duhura për ofrimin e ndihmës ligjore. Konkretisht, Ministria e Drejtësisë nuk duhet të mjaftohet vetëm me një kthim përgjigjeje por duhet të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të asistojë kërkuesen/in për zgjidhjen e çështjes së ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke pasur garantuar një interes publik, siç është interesi i fëmijëve.

Detyrimi për të mbrojtur interesin e fëmijës përbën një parim thelbësor në sistemin juridik shqiptar të cilin Gjykata e nënvizon duke nxjerrë në pah detyrimin e institucioneve shtetërore për të trajtuar me përparësi dhe shpejtësi çështjet, të cilat lidhen me interesat e fëmijëve. Në këtë mënyrë, veprimi institucional shtetëror duhet të priret edhe nga detyrimi i tij ligjor për të zbatuar në mënyrë efektive konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, jo vetëm për shkak të statusit të së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik vendas, por edhe për mbrojtjen e të drejtave në mënyrë konkrete dhe efektive.

21 Vendim nr. 24 datë 21.04.2014 (V-24/14) i Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë

### 3. Praktika të mira të ndërveprimit midis shteteve të ndryshme dhe rasti i ndërveprimit në Bashkimin Evropian (rasti i Rregullores CE N. 4/2009 Mbi detyrimet ushqimore). Rasti i Italisë dhe Gjermanisë

Është gjithmonë e vështirë por jo e pamundur forcimi në përmbushjen e detyrimit ushqimor në rastet e ushtrimit të të drejtës së përkujdesjes së prindërve ndaj fëmijëve që jetojnë në një vend të ndryshëm me atë të prindit debitor dhe jo ushtrues i përgjegjesisë prindërore. Në shumë raste ndërkombëtare janë bërë përpjekje të vazhdueshme dhe gati konsumuese për punonjësit socialë dhe ekspertët e fushës në realizimin e kësaj praktike, kjo pasi nevojiten standarde specifike që kanë të bëjnë me provat e ofruara, dokumentet dhe baza ligjore, uniformiteti në procedurë apo dhe në mënyrat e komunikimit. SHBA-të p.sh janë ndër vendet e para të cilat vlerësuan dhe evidentuan rëndësinë që firmosja e kësaj konvente nga ana e tyre apo dhe e shteteve të tjera mbart në vetvete. Me firmosjen e kësaj Konvente i vihet në ndihmë ofritim të garancive për mbështetje ndërkombëtare kundrejt forcimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve e konkretisht të detyrimit ushqimor ndaj tyre dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes.

Mbështetësit dhe propozuesit për ratifikimin e Konventës së Hagës dhe të neneve përbërëse të saj vënë theksin në situatën reale që fenomeni i braktisjes së familjes dhe i detyrimeve familjare të prindërve kundrejt fëmijëve apo pjesëtarëve në nevojë, anëtarë të tjerë të familjes së tyre është rritur ndjeshëm, kjo edhe si pasojë e lirisë së lëvizjes dhe jetesës në një botë pa kufij. Gjithmonë e më shumë një numër shtetas, ndër ta pjesa më e madhe përbëhet nga shtetas Amerikanë, të cilët je-

tojnë jashtë shtetit të tyre të origjinës dhe mbajnë mbi vete detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve të tyre (apo forma të tjera të mbështetjes për anëtarët e familjes ndaj të cilëve janë debitor) ashtu si kundër shumë emigrantë me fëmijë që jetojnë në vende të ndryshme si dhe në SHBA ndaj të cilëve prindërit e tyre janë përgjegjës për mirëritje dhe edukim. Këta ithtarë të Konventës kërkojnë me ngulm që prindi debitor (jo përgjegjës ligjërisht për mirëritje dhe edukim) me një residencë në një vend të ndryshëm nga ajo e fëmijëve të mos bëhet shkak për mohimin e të drejtës së fëmijëve për të marrë detyrimin ushqimor për të cilin ky prind është ligjërisht i detyruar.

Dhimbja e një divorci ose ndarjeje bëhet dhe më e prekshme nën presionin ekonomik dhe emocional që krijohet kur një prind jeton jashtë vendit dhe refuzon të paguajë mbështetjen e duhur financiare. *Sipas të dhënëve nga burimet zyrtare të BE-së, nga 16 milionë çifte ndërkombëtarë që jetojnë sot në BE dhe me rreth 30 milionë qytetarë evropianë rezidentë në vendet e treta, problemi i gjetjes së një korrespondence nga jashtë për pagesën e detyrimit ushqimor për fëmijëve është e destinuar të rritet. Çështja e rikuperimit ndërkombëtar të detyrimeve ushqimore përbën një problem të një rëndësie të veçantë për mirëqenien e personit, mirëqenie e cila mund të komprometohet në rast se detyrimi ushqimor nga ana e prindit debitor do të mungojë.*

Në këtë kuadër, Bashkimi Evropian, edhe pse disponon një kuadër aktesh ligjore të cilat garantojnë që i mituri të mund të marrë mbështetjen financiare nga ana e prindit i cili jeton në një shtet anëtar të BE, ka marrë masat në forcimin e mëtejshëm të legjislacionit me anë të:

- Rregullores së miratuar nga Këshilli Evropian (BE)<sup>22</sup> i cili në emër të Bashkimit, realizon firmosjen e Konventës së Hagës të 2007 (adaptuar në 18 dhjetor 2008) mbi rikuperimin ndërkombëtar të detyrimeve ushqimore kundrejt fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes nga prindi debitor. Në rastin e një familjeje të ndarë, ata që vuajnë më shumë janë gjithmonë fëmijët. Nënshkrimi i kësaj konvente ndërkombëtare, ofron garanci të plota BE-së që fëmijët do të gëzojnë mbrojtje të njëjtë edhe në qoftë se një prind lëviz jashtë BE-së. Interesi i fëmijës mbizotëron mbi të gjitha garancitë dhe të drejtat e palëve dhe prindërit nuk duhet t'u shmangen përgjegjësi të tyre duke lënë territorin e Bashkimit.

Për shembull, si do të veprohet në rastin e një çifti që jeton në Francë e që më pas zgjidhin martesën, dhe babai i familjes transferohet në Shtetet e Bashkuara: fëmija do të vazhdojë të marrë shumën e parave të caktuar nga vendimi gjyqësor i dhënë nga gjykatësi francez? Sipas Konventës së nënshkruar nga Bashkimi Evropian, autoritetet amerikane do të bashkëpunojnë me ato evropiane në mënyrë që i ati të përmbushë detyrimet e tij dhe fëmija të marrë mbështetjen financiare në dobi të tij.

22 Vendimi 2011/220/UEi Këshillit të datës 31 mars 2011, e vlefshme për firmën në emër të Bashkimit Evropian të Konventës së Hagës të 23 Nëntorit 2007 Mbi rikuperimin ndërkombëtar të detyrimit ushqimor për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes, publikuar në Gazetën Zyrtare të 7 Prill 2011, L. n. 93.

Shpesh herë Bashkimi Evropian, përsa i përket bashkëpunimit gjyqësor civil me vendet e treta, ka zgjedhur rrugën e ratifikimit të disa prej konventave të caktuara ndërkombëtare në vend që të hyjë në marrëveshje dypalëshe me secilin Shtet për të siguruar një koherencë midis instrumenteve të ndryshme ligjore. Kështu miratimi i instrumenteve që janë krejtësisht në përputhje me *acquis* (p.sh. tërësia e të drejtave dhe detyrimeve ligjore dhe objektivat politike që bashkojnë dhe të lidhin shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat duhet të mirëprehen pa rezerva nga vendet që dëshirojnë të bëhen pjesë e BE-së) do të garantojë vendosjen e marrëdhënieve me vendet e treta, pa frikën e ekzistencës së dallimeve të mundshme gjatë aplikimit.

Kështu çështjet e rregulluara nga kjo Konventë bëjnë pjesë në fushën e zbatimit të Rregullores nr. 4/2009 të Këshillit (Rregullorja dhe Protokollin mbi ligjin në fuqi u aplikuan nga Shtetet Anëtare të BE-së, nga 18 qershor 2011) të datës 18 dhjetor 2008 lidhur me *juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe bashkëpunimit në çështjet që lidhen me detyrimet ushqimore*<sup>23</sup>. Me këtë rregullore, legjislatura e BE –së ka propozuar një sërë masash për të siguruar rikuperimin efektiv të detyrimeve ushqimore në rastet e situatave ndërkufitare duke lehtësuar, në këtë mënyrë, *lëvizjen e lirë të personave brenda Bashkimit Evropian*.

Kjo Konventë krijon një sistem në nivele botërore për rikuperimin e detyrimeve ushqimore në favor të fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, duke krijuar një kornizë të përbashkët ligjore për BE-në dhe vendet e treta, të cilat e kanë ratifikuar dhe që do të lehtësojë njohjen dhe ekzekutimin e kërkesave për shlyerjen e detyrimeve ushqimore. Konventa ofron njohjen dhe ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve të detyrimeve ushqimore të gjykuara në cilindo nga shtetet nënshkruese, duke i lejuar në këtë mënyrë, fëmijëve të drejtën për të përfituar nga ekzekutimi i menjëhershëm i të drejtës së tyre për rikuperimin e detyrimit ushqimor nga prindi debitor në të gjitha Shtetet Anëtare dhe në të njëjtën kohë autoritetet publike bashkëpunojnë në zbatimin e detyrimeve ushqimore në mënyrë që palët e detyruara të mos mund t'i shmangen detyrimeve të tyre duke lënë territorin e BE-së.

Meqenëse pjesa më e madhe e kërkesave për shlyerjen e detyrimeve ushqimore i përkasin fëmijëve, Konventa merr një rëndësi parësore dhe ofrohet si mjet mbrojtjeje të të drejtave të tyre, duke krijuar një sistem të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kombëtare në të gjithë botën, duke parashikuar edhe ndihmë ligjore

23 Konventa e Hagës e 2007 u ratifikua nga Bashkimi Evropian më 9 prill 2014 dhe hyri në fuqi për të gjitha Shtetet Anëtare me përjashtim të Danimarkës që u realizua më 1 gusht 2014. Protokollin u miratua më 8 prill 2010 nga Bashkimi Evropian dhe, pas hyrjes në fuqi të Rregullores për detyrimet ushqimore të 18 qershorit 2011, e cila aplikohet midis të gjitha shteteve anëtare, përveç Britanisë së Madhe dhe Danimarkës. Shtetet anëtare të BE-së do të zbatojnë Konventën e Hagës të vitit 2007 vetëm me vendet extra UE-së që aderohet në të. Dispozita të reja do të zbatohen në të gjitha 28 shtetet anëtare, duke përfshirë edhe Danimarkën mbi bazën e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Mbretërisë së Danimarkës në lidhje me juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare, nënshkruar më 19 tetor 2005. Megjithatë, në Danimarkë nuk zbatohet asnjë rregull të caktuar, në mënyrë të veçantë, ato mbi ligjin e aplikueshëm dhe mbi bashkëpunimin midis autoriteteve qendrore.

falas (n. 44 e më tej i Rregullores) në ngarkim të Shtetit<sup>24</sup>, në rastet e detyrimeve ushqimore për fëmijët dhe për thjeshtësimin e procedurave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet e detyrimeve ushqimore. Për më tepër, ky sistem krijon mundësitë për përshpejtimin e procedurave, aktualisht të gjata dhe komplekse, për të evidentuar debitorët në arrati. Shteti Anëtar i kërkuar do të japë ndihmën ligjore falas për të gjitha kërkesat në lidhje me detyrimet ushqimore që lindin nga një marrëdhënie prind-fëmijë kundrejt një personi nën moshën 21 vjeç të paraqitur nga një kreditor nëpërmjet autoritetit qendror. Megjithatë, në lidhje me kërkesat për miratimin apo ndryshimin e një vendimi në lidhje me detyrimet për ushqim, autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar të kërkuar mund të refuzojë dhënien e ndihmës juridike falas nëse e konsideron kërkesën apo apelin si haptazi të pabazuar. Kushtet e aksesit për ndihmë ligjore në varësi të Shtetit nuk duhet të jetë më kufizuese se ato u jepen palëve për raste të ngjashme brenda territorit. Ndihma juridike shtetërore siguron asistencën e nevojshme për t'u mundësuar palëve të njohin dhe të mbrojnë të drejtat e tyre dhe të sigurojnë që kërkesat e tyre do të trajtohen në mënyrë efikase. Ajo mbulon, sipas rastit:

- këshillime para procesit gjyqësor;
- ndihmë ligjore për të apeluar para një autoriteti, ose një gjykatë si dhe përfaqësimin në gjykatë;
- përjashtimin ose marrjen përsipër të shpenzimeve gjyqësore dhe tarifave/honoraret;
- Shpenzimet ndaj palës së suksesshme nga pala humbëse që përfiton nga ndihma juridike shtetërore falas në qoftë se kjo ndihmë për detyrimet ushqimore do të mbulonte këto shpenzime, nëse përfituesi do të kishte vendqëndrimin e zakonshëm në Shtetin Anëtar të gjykatës shqyrtuese të çështjes;
- përkthimi;
- Përkthimi i dokumenteve të nevojshme për zgjidhjen e çështjes gjyqësore nga gjykata ose nga organi kompetent të paraqitur nga përfituesi i ndihmës juridike të ofruar nga shteti;
- Shpenzimet e udhëtimit në ngarkim të përfituesit të ndihmës ligjore falas ofruar nga Shteti si dhe të personave të tjerë të cilët duhet të jenë fizikisht të pranishëm gjatë procesit gjyqësor për t'u dëgjuar, kur gjykata vendos se nuk do të ketë një tjetër mundësi për të dëgjuar këta persona.

Ende nuk ka të dhëna statistikore në nivel ndërkombëtar për numrin e rasteve të kërkesave për detyrimet ushqimore që kërkojnë njohjen apo ekzekutimin ndërkombëtar të vendimeve të detyrimeve ushqimore. Vetëm në vitin 2007, kanë ndodhur rreth 1.2 milion divorce në 27 vendet e BE. Këto shifra janë tregues të

24 Shpenzimet e ndihmës ligjore të ofruara nga Shteti jepen në përputhje me legjislacionin kombëtar (duke përfshirë vlerësimin e burimeve të paditësit apo të vlefshmërisë së kërkesës së bërë), kur nuk është parashikuar në përputhje me Rregulloren. Në bazë të dispozitave të Rregullores, ndihma juridike në varësi të Shtetit duhet të jetë në dispozicion jo vetëm për realizimin e procedurave gjyqësore, por edhe kur vendimet dhe procedurat për njohjen ose zbatimin/ekzekutimin e detyrimeve ushqimore janë të kryera ose të zbatuara nga autoritetet e tjera, në përputhje me procedime të bëra përpara tyre.

një problemi serioz në aspektin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave mbi detyrimin për ushqim nga prindërit mungues/debitor të cilët nuk jetojnë në BE.

**Autoritetet qendrore** të ngritura në bazë të Rregullores<sup>25</sup> luajnë një rol më të madh se sa ai në instrumente të tjera të lidhura me detyrimet ushqimore. Në veçanti, ato janë të detyruar të ndihmojnë kreditorët që kërkojnë ekzekutimin apo marrjen e vendimeve gjyqësore në lidhje me detyrimet ushqimore. Në çdo Shtet Anëtar ka të paktën një autoritet qendror; Shtetet anëtare që kanë disa sisteme ligjore ose Shtetet Anëtare të cilat kanë disa autoritete autonome territoriale mund të caktojnë më shumë se një autoritet qendror. Funkcionet e autoriteteve qendrore janë përshkruar në detaje në rregullimin. Autoritetet qendrore mund të ndërmarrin masat e duhura apo të inkurajojnë përcaktimin e tyre për të ndihmuar kreditorët e detyrimeve ushqimore për të marrë pagesën e shumave të përcaktuara, duke përfshirë edhe vendndodhjen e debitorëve dhe, në rastet e duhura, të informacionit mbi të ardhurat, pasuritë dhe llogaritë bankare të tij. Në ushtrimin e detyrave të tyre, autoritetet qendrore janë të detyruar të bashkëpunojnë dhe të transmetojnë kërkesat dhe informacionet tek autoritetet përkatëse, duke përfshirë gjykatat. Autoritetet qendrore nuk ngarkojnë ndonjë kosto për shërbimet e ofruara. Funkcionet e autoritetit qendror mund të ushtrohen deri në masën e lejuar nga ligji kombëtar i Shtetit Anëtar të interesuar, nga ana e autoriteteve publike apo organeve të tjera që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve kompetente të atij Shteti Anëtar.

*Në mënyrë që të lehtësojë zbatimin praktik të Rregullores për detyrimet ushqimore dhe ushtrimin efektiv të të drejtave të qytetarëve në të gjithë BE-së, Rrjeti Gjyqësor Evropian në çështjet civile dhe tregtare ka zhvilluar një formë/formular standard jo detyrues mbi deklarinë e detyrimeve ushqimore të prapambetura e të papaguara.*

### 3.1. Si realizohet përmbushja e detyrimeve ushqimore në kuadër të zbatimit të Konventës së Hagës, sipas të drejtës italiane

Sipas të *Drejtës Italiane* për ekzekutimin /njohjen e vendimeve mbi detyrimet ushqimore, në zbatim të Konventës së Hagës, parashikohet konkretisht se subjektet të cilat i nënshtrohen detyrimit ushqimor janë: bashkëshorti; fëmijët; prindërit dhe në mungesë të tyre, paraardhësit e afërm; dhëndri dhe nusja; vjehri/vjehrra; vëllezërit dhe motrat.

Detyrimi lind nga një person i shkallës më të afërt, sipas rendit të mësipërm. Në rastin kur ka më shumë persona në të njëjtën radhë, detyrimi ndahet në proporcion me kushtet e tyre ekonomike.

Në rast zgjidhje martese prindërit janë të detyruar ekonomikisht të mbështesin rritjen dhe edukimin e fëmijës së tyre, duke respektuar vendimin e gjykatës që për-

25 Nenet 49 – 63 të Rregullores

cakton pagesën e një detyrimi financiar periodik, duke marrë parasysh nevojat e fëmijës, standardin e jetesës së gëzuar nga fëmija gjatë jetesës më të dy prindërit e tij, koha e kaluar me secilin prind, burimet ekonomike të të dy prindërve dhe vlera ekonomike e punëve të shtëpisë dhe kujdesit të kryer nga secili prind.

Për të realizuar të drejtën e tij për caktimin e një detyrimi ushqimor, personi i interesuar, dhe që në rastin e fëmijëve është bashkëshorti /prindi gjatë procedurave të divorcit, me anë të padisë i drejtohet Gjykatës së vendbanimit të tij, bashkëngjitur të gjitha dokumentet që mund të provojnë gjendjen e tij të nevojës. Është fakt që çështja e caktimit të një detyrimi ushqimor realizohet nëpërmjet shërbimeve të një avokati, i cili është pjesë në gjykim. Nuk e nevojshme ndihma e një avokati në qoftë se detyrimi ushqimor është përfshirë në marrëveshjen e bërë mes të dy bashkëshortëve në rast divorci. Në këtë rast, marrëveshja paraqitet në gjykatë e cila vlerëson autenticitetin e saj.

Vënia në lëvizje e drejtësisë kushton por në rastin e procedurës në lidhje me mbajtjen e fëmijëve, ajo është e përjashtuar nga taksat apo tarifatat gjyqësore. Është pala e interesuar ajo që mbulon kostot e avokatit që e përfaqëson në gjykatë. Në rastin kur pala ka të ardhura vjetore të tatueshme që nuk i kalon 10.766.33 € në vit, ajo mund të kërkojë ndihmë ligjore falas nga Shteti. Formulari i aplikimit për ndihmë juridike i paraqitet Këshillit të Dhomës së Avokatëve të vendit ku është gjykata përgjegjëse për çështjen. Në aplikim është e nevojshme që të tregohen arsyet faktike dhe ligjore të cilat përcaktojnë kërkesën dhe të dorëzohen dëshmitë përkatëse të dokumentuara, me qëllim që Këshilli i Dhomës të vlerësojë nëse pretendimet janë të mbështetura në ligj apo jo. Nëse Këshilli pranon kërkesën, personit të interesuar i caktohet një mbrojtës i zgjedhur nga lista e avokatëve të paguar nga Shteti. Nëse kërkesa për ndihmë juridike falas nuk pranohet, aplikanti mund t'ia rikërkojë atë gjykatësit që po shqyrton çështjen. Vendimi gjyqësor përcakton formën dhe mënyrën e pagesës së detyrimit për ushqim. Në rast divorci, gjyqtari mund të urdhërojë palët e treta për të paguar rregullisht shumat e parave që përbëjnë detyrimin (p.sh.. Punëdhënësi) direkt bashkëshortit të ndarë. Pagesa bëhet në emër të kreditorit. Në rastin e fëmijës, pagesa bëhet në emër të bashkëshortit i cili ka kujdestarinë e fëmijës. Në rastin e fëmijës madhor por jo ekonomikisht të pavarur, pagesa bëhet direkt ndaj përfituesit. **Por në rastin kur debitori nuk paguan vullnetarisht, si veprohet?** Në qoftë se debitori nuk paguan vullnetarisht detyrimin ushqimor apo për rritje dhe edukim, kreditori ka në dispozicion të tij mjetet e zakonshme për ekzekutimin e detyruar të detyrimeve monetare. Mund të marrin masa mbrojtëse parandaluese për të mbrojtur pasurinë e tij, mund të veprojnë në rrugë përmbarimore, duke konfiskuar pasuritë ose shumat e marra borxh nga palët e treta. Mospagesa e shumave të detyrimit mund të jenë pjesë e gjykimit për veprën penale Të shkeljes së detyrimeve për ndihmë familjare (neni 570 Kodi Penal.); duke qenë se kjo është një vepër penale që ndiqet mbi ankesën e viktimës, por në rastin kur destinatarit është i mituri ndiqet nga Prokuroria. Përdorimi i forcës së ligjit penal ishte shumë efektive në Itali për të kundërshtuar sjellje të kundërta kundrejt mospërbushjes së detyrimeve në ngarkim të bashkëshortit – që nuk ka kujdestarinë.



E drejta për ushqim, në vetvete, nuk është objekt i kufizimit, por vetëm në rast se kalojnë pesë vite nga mospagimi i kësteve të detyrimit për ushqim (art. 2948, n. 2, cod. Civ.). Për më tepër, afati i parashkrimit pezullohet midis bashkëshortëve dhe atyre që kanë përgjegjësi prindërore dhe personave që janë objekt i saj. Nuk ka një autoritet publik ose privat që të mund ofrojë pagesën e detyrimit ushqimor tërësisht ose pjesërisht, në vend të debitorit. Në rastin kur kërkuesi (kreditori) është në një Shtet Anëtar dhe debitori banon në një vend tjetër ai mund t'i drejtohet Autoritetit Qendror italian me anë të një kërkesë për njohje, deklarin e ekzekutueshmërisë dhe ekzekutimi i vendimit duke njohur të drejtën e tij për detyrimin ushqimor, në zbatim të sistemit të bashkëpunimit të vendosur nga Kapitullit VII të Rregullores së KE 4/2009, neni 49, konkretisht Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti i Drejtësisë për të Mitur. Në rastin kur kërkuesi është në një vend të tretë dhe debitori është në një Shtet Anëtar, ai mund ti drejtohet Autoritetit Qendror të Shtetit Anëtar të rezidencës së debitorit e paraqet një kërkesë në përputhje me nenin 56, duke përfituar nga sistemi të bashkëpunimit të vendosur nga Kapitullit VII të Rregullores së KE-4/2009. Si pasojë ky pretendim nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër apo organizatat private në Itali. Në lidhje me aksesin në drejtësi, në kontestin ndërkufitar, aplikohet direkt skema e përcaktuar nga Kapitulli V i Rregullores KE 4/2009. Në bazë të Kapitullit VII, autoriteti qendror italian përdor metodologjinë e mëposhtme kundrejt trajtimit të një kërkesë për bashkëpunim të transmetuar:

- inkurajon zgjidhje miqësore, duke i dërguar debitorit një ftesë për të përmbushur vullnetarisht detyrimin kundrejt tij;
- i kërkon debitorit të marrë kontakt me Autoritetin Qendror për të rënë dakord mbi mënyrën shlyerjes së detyrimit;
- lokalizon vendndodhjen e debitorit në bazë të të dhënave të marra nga Indeksi Kombëtar i komunave italiane dhe të dhënave të marra nga departamenti i administratës së burgjeve, ose duke kontaktuar zyrat e gjendjeve civile;
- mbledh informacion mbi të ardhurat dhe pasuritë e debitorit duke përdorur policinë tatimore;
- lehtëson mbledhjen e provave dokumentare, si masë e veçantë e parashikuar nga neni. 51, paragraf 2, shkronja. g) e Rregullores, duke ndërvepruar me autoritetet gjyqësore;
- operon për dhënien e ndihmës juridike falas në ngarkim të Shtetit konform përcaktimit të bërë në pikët e mësipërme 7 & 18.

### 3.2. Si realizohet përmbushja e detyrimeve ushqimore në kuadër të zbatimit të Konventës së Hagës sipas të drejtës gjermane

Sipas të *Drejtës Gjermane* për ekzekutimin /njohjen e vendimeve mbi detyrimet ushqimore, në zbatim të Konventës së Hagës, parashikohet konkretisht se sub-

jektet të cilat i nënshtrohen detyrimit ushqimor janë: Nuk është një detyrim për të paguar mirëmbajtjen në mes të palëve tregohet më poshtë:

- fëmijët ndaj prindërve të tyre;
- prindërit ndaj fëmijëve të tyre;
- bashkëshortët, njëri ndaj tjetrit;
- e (stër) nipërit kundër (stër) gjyshërve;
- të (stër) gjyshërit kundrejt nipërve e mbesave;
- prindërit e pamartuar, kundrejt njëri tjetrit;
- partnerët në një lidhje të regjistruar, kundrejt njëri - tjetrit.

Sipas normativës gjermane nuk ka kufi moshe për detyrimin për ushqim për fëmijët: kompensimi paguhet përsa kohë fëmija ka nevojë për mbështetje, me përjashtim të rasteve kur ka një krim apo faj të bërë nga ai. Pas periudhës së arsimimit dhe trajnimit, pritët që fëmijët të sigurojnë vetë jetesën e tyre. Në të drejtën gjermane në pagimin e detyrimit ushqimor në favorizohen më shumë fëmijët e mitur se sa të rriturit: kërkesat në këtë fushë kundrejt personit të detyruar janë më rigorozë dhe fëmijët e mitur në përgjithësi, kanë më prioritet mbi ata madhor. Si rregull, në të drejtën gjermane mbi detyrimin ushqimor kreditori duhet ti drejtohet një gjyqtari, Zyres e Kujdesit për Fëmijët (Jugendamt), ose një noteri për të marrë një titull ekzekutiv (vollstreckungsfähiger Titel) për të mbledhur detyrimisht shumat e parave detyrimi ligjor. Çështja zhvillohet vetëm para gjykatës. Megjithatë, nga noteri ose nga Zyra e kujdesit për fëmijët mund të njihet një pretendimi për një detyrim ushqimor. Zyra përgjegjëse për t'u kujdesur për fëmijët ka funksion më të kufizuar sesa noteri: Zyra është kompetente për të njohur një detyrim ushqimor ndaj fëmijës deri në moshën njëzet e një vjeç ose pretendimeve prindërore që vijnë nga lindja e një fëmije.

Procedurat në lidhje me detyrimet ushqimore përfshijnë kosto (tarifat dhe shpenzimet ligjore). Taksat gjyqësore (të barabartë me trefishin e tarifës bazë gjyqësore) paguhet në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Shuma e këtyre shpenzimeve është llogaritur në bazë të vlerës së padisë (Verfahrensëert). Edhe avokatët janë të shpërblehen në bazë të vlerës së padisë. Vlera e marrë parasysht në një çështje mbi detyrimet ushqimore jepet nga shumat e kërkuar për dymbëdhjetë muajt e parë pas dorëzimit të kërkesës, por nuk mund të tejkalojë shumën totale të kërkesës. Çdo shumë që lidhet me detyrimin ushqimor i shtohen totalit të aplikimit.

Sipas të drejtës gjermane detyrimi për ushqim në përgjithësi, paguhet çdo muaj dhe paraprakisht personit që ka të drejtën, ose, nëse ky i fundit është i mitur, prindit i cili kujdeset me të ose ndonjë personi tjetër i autorizuar për të marrë pagesën.

### **Po në qoftë se personi që mbart detyrimin për ushqim (debitori) nuk e paguan vullnetarisht atë cilat rrugë do të ndiqen?**

Një alternativë për t'u marrë parasysht është ekzekutimi i detyrueshëm (Zwangsvollstreckung) i kërkesës për detyrimin ushqimor të përcaktuar. Ekzekutimi i detyrueshëm realizohet në përputhje me rregullat dhe ligjin e brendshëm.

Megjithatë, detyrimi ushqimor në ngarkim të debitorit është përforcuar nga fakti se çdo mospërbushje eventuale e detyrimit është e dënueshme me ligj.

Një person i cili shkel një detyrim ushqimor mund të dënohet me burgim deri në tre vjet ose me gjobë. Nëse dënimi me burg është e pashmangshme, gjykata mund të pezullojë dënimin dhe të urdhërojë palën e humbur për të përmbushur detyrimet ushqimor të saj. Më pas, gjykata mund të revokojë pezullimin e dënimit nëse pala e dënuar kryen një shkelje serioze ose të vazhdueshme të vendimit për detyrimin ushqimor, me arsyetimin për shkak të frikës se mund të kryejë krime të tjera dhe, në veçanti, një shkelje të detyrimeve ushqimor në ngarkim të tij. Në të kundërt, në rastin e personave të padënuar, prokuroria mund të pezullojë (ose mos fillojë) përkohësisht ndjekjen penale ose gjykata mund të ndalojë përkohësisht procedurën penale, me kusht që të pandehurit ti jetë dhënë kohë për të paguar borxhin e saj në shlyerjen e detyrimit ushqimor.

Pasuritë e luajtshme të debitorit mund të konfiskohen (Pfändung) nga përmbaruesi (Gerichtsvollzieher) (neni 808, paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Civile). Rastet në të cilat lejohet konfiskimi përcaktohen nga nenet 811-812 të Kodit të Procedurës Civile, përveç të mirave materiale të përcaktuar në nenin 811K.Pr.C.

Vendbanimi i debitorit mund të kontrollohet pa pëlqimin e tij vetëm me një mandat të veçantë të gjyqtarit (neni 758 i Kodit të Procedurës Civile).

Procedura e konfiskimit të të mirave në garantim të kredisë së kreditorit trajtohet nga gjyqtari që merret me procedurat e ekzekutimit. Konfiskimi i të ardhurave të fituara nga puna janë subjekt i kufizimeve të imponuar nga nenet 850 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Shkalla në të cilën të ardhurat e debitorit janë të përjashtuara nga konfiskimi lidhen jo vetëm me nivelin e të ardhurave të tij, por edhe numrit të atyre që kanë të drejtë të marrin detyrim ushqimor prej tij.

Përfitimet për fëmijët dhe pagesat e tjera mbrojtëse gëzojnë mbrojtje shtesë. Për të marrë këtë lloj mbrojtjeje, debitori duhet zakonisht të japë dëshmi në bankë. Në raste të veçanta (si në rastin në të cilin debitori ka nevojë për shkak të sëmundjes) shuma e llogarisë rrjedhëse që nuk cenohet nga mbajtja forcërisht nga banka mund të rregullohen në mënyrë specifike nga gjykata që merret me ekzekutimin (neni 850K, paragrafi 4 Kodi Pr. Civile).

Vetë kreditori sipas të drejtës gjermane mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, e drejtë e tij. Megjithatë, Zyra e kujdesit për fëmijët ndihmon për të marrë detyrimin ushqimor për të miturin që po asiston. I mituri merr ndihmë me kërkesë të prindit që ka përgjegjësinë prindërore mbi fëmijën. Nëse përfituesi i të përfitimeve sociale (ndihmë ekonomike, asistencë sociale etj) ka një kërkesë për përmbushje të detyrimit ushqimor të prapambetur, kjo kredi normalisht transferohet tek autoriteti kompetent, që të mund ta kërkojë në emër të tij ( të vetë organit).

Në disa raste, kur një fëmijë është rritur nga një prind i vetëm dhe prindi tjetër nuk paguan në ushqime të holla, ligji gjerman në lidhje me paradhënien e pagesës për detyrimin ushqimor (Unterhaltsvorschussgesetz-UVG) siguron mundësinë

për të bërë pagesat për një periudhë të kufizuar. Në këto raste është Kasa për paradhënien e detyrimit ushqimor (Unterhaltsvorschusskasse) që mbledh kredinë e detyrimit ushqimor që i transferohet asaj.

Në qoftë se debitori nuk përmbush detyrimin për ushqim dhe aplikon për ndihmë sociale (Sozialhilfe) - nëse ka kushte të tjera që i japin të drejtë - pretendimet për detyrimin ushqimor i kalojnë institucionit të mbrojtjes sociale (të ngjashme me atë që ndodh për paradhënien mbi detyrimet ushqimore), e cili nga ana e tij mund ti rikërkojë ato. Në rastin e përfitimeve sociale bazë për punëkërkuarit e papunë (Grundsicherung für Arbeitssuchende), kredia për detyrimin ushqimor transferohet vetëm pas njoftimit me shkrim të debitorit të detyrimit ushqimor nga ana e entit të përkujdesjes.

Të gjitha paradhëniet e lartpërmendura si: paradhënia apo pagesat nga asistencja sociale dhe mbështetja financiare për punëkërkuarit konsiderohen si mbulime financiare sociale të pavarura të limituara, por jo detyrimeve ushqimore të mirëfillta, paguhen nga autoritetet kompetente drejtpërdrejt personit që ka të drejtën dhe nuk varen nga mundësitë e rikuperimit të kërkesës për shlyerjen e detyrimit ushqimor. Organet publike të cilëve u transferohet kërkesa e detyrimit ushqimor mund të kërkojnë rikthimin e saj në emër të tyre.

Në rastin e ndihmës së ofruar nga Zyra e kujdesit për fëmijët në lidhje me kërkesat për ekzekutim të detyrimit ushqimor nuk kemi të bëjmë me një kërkesë të veçantë nga organi publik. Në këtë rast, organi publik kufizohet në ndihmën ndaj personit që ka të drejtën për të kërkuar dhe realizuar shlyerjen e detyrimit. Autoriteti qendror përgjegjës gjerman që ofron ndihmën e tij është Zyra Federale të Drejtësisë në Bon (Bundesamt für Justiz). Kërkesa prezantohet ndaj autoritetit qendror në vendin e rezidencës (vendbanimit) që mund të jetë dhe një vend i tretë, i cili duhet t'ia transmetojë autoritetit qendror të Republikës Federale Gjermane, që ka nënshkruar Konventën e Hagës të 2007. Sipas të drejtës gjermane për rastet ndërkombëtare të BE-së mbi aksesin në drejtësi në lidhje me fushën e rregullores për ekzekutimin e detyrimeve ushqimore (kapitulli V), parashikohet që si zakonisht, pagesat e taksave për detyrimet ushqimore paguhen paraprakisht. Ndihma ligjore falas nga shteti ofrohet konform neneve 44 dhe 47 të Rregullores. Detyrimi për të paguar paraprakisht nuk zbatohet në rrethana të caktuara, veçanërisht në qoftë se është lejuar mbulimi i shpenzimeve ligjore nga Shteti. ***Po cilat janë masat që merren nga ai Shtet Anëtar për të siguruar funksionimin e aktiviteteve të përshkruara në nenin 51 të Rregullores për detyrimin ushqimor?*** Shteti gjerman u ka atribuar autoritetit qendror, Zyrës Federale të Drejtësisë, pushtetet e nevojshme për të garantuar efikasitetin e masave të përshkruara në nenin 51 të Rregullores.

Gjermania i ka dhënë autoritetin qendror - Zyra Federale e Drejtësisë - kompetencat e nevojshme për të siguruar efektivitetin e masave të përcaktuara në nenin 51.

## 4. Situata reale mbi zbatimin në Shqipëri të Konventës së Hagës

### 4.1. Kuadri Ligjor ekzistues mbi detyrimin ushqimor për fëmijët dhe ekzekutimin e tij

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) si një ndër parimet themelore të saj, ka sanksionuar parimin e barazisë së shtetasve para ligjit: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkak të tilla si gjinia...*”. Ajo si garantuesja themelore e të drejtës së çdo individi për t’u martuar dhe pasur një familje, njeh detyrimin e Shtetit për ta mbrojtur në mënyrë të veçantë këtë institucion ashtu sikundër . detyrimin e ligjvënësit dhe të qeverisë shqiptare të marrë masat e duhura për të rregulluar ligjërisht lidhjen dhe zgjidhjen e martesës. Në nenin 53 i Kushtetutës garantohet mbrojtje e veçantë për martesën dhe familjen. Kushtetuta cilëson se “*Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje; Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit; Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.*”<sup>26</sup> Kushtetuta në nenin 54 të saj garanton mbrojtjen e fëmijëve, sipas të cilit ata gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti<sup>27</sup>. Mbrojtja e fëmijëve nga ana ligjore është parë fillimisht duke ju siguruar atyre formalizmin e familjes, pra të drejtën për të pasur të njohur ligjërisht amësinë dhe atësinë si dhe gëzimin real të së drejtës për një jetë familjare normale. Në

26 Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: 1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. 2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit. 3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.

27 Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: 1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa. 3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

këtë kuptim, koncepti kushtetues i familjes gjen plotësisht përputhje me Kodin e Familjes i cili rregullon në mënyrë të veçantë marrëdhëniet familjare dhe tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që kjo marrëdhënie prodhon për palët. Në këtë mënyrë konstatojmë se, tërësia e dispozitave kushtetuese garanton të drejtën për të krijuar një familje; të drejtën për të jetuar me / në familje; të drejtën për të respektuar barazinë bashkëshortore, si dhe garantimin e mbrojtjes së posaçme të fëmijëve, përmes një kuadri ligjor në përputhje me këto dispozita.

### • Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Konventa Për të Drejtat e Fëmijës u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Shkurt 1992 dhe hyri në fuqi në Mars 1992. Kjo konventë<sup>28</sup> nuk ofron vetëm një panoramë të të drejtave të fëmijëve, por jep edhe një radhitje të përgjegjësive kundrejt fëmijëve, të cilat shtetet janë të gatshme t'i njohin dhe mbrojnë. Si detyrime të drejtpërdrejta që burojnë nga kjo Konventë radhiten detyrimet në formën e dhënies së mundësisë për arsimim apo sigurimit të gjykimit të përshtatshëm; ose detyrime indirekte si p.sh. dhënia e mundësisë prindërve, familjes apo kujdestarëve për marrjen e përgjegjësisë së kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijës.

Dy janë konceptet mbi të cilat bazohet Konventa:

1. Interesi më i mirë i fëmijës (Neni 3) i cili merr karakter detyrues për të gjitha masat që kanë në qendër të tyre fëmijët<sup>29</sup>.
2. Prindërit apo personat e tjerë përgjegjës duhen përkrahur dhe mbështetur gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, në respektim të interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 4 i Konventës përcakton detyrimin e shteteve për të bërë gjithçka është e nevojshme për zbatimin e konventës dhe për garantimin e realizimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve, duke përdorur për këtë qëllim mjetet që kanë në dispozicion (...). Për këtë arsye, shteti duhet të marrë masa serioze për garantimin e burimeve financiare dhe njerëzore.

28 Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 me Rezolutën Nr. 44/25. Ajo u firmos për një kohë të shkurtër nga 61 vende të botës, reagim ky i pashënuar më parë pas një marrëveshjeje të Kombeve të Bashkuara. Hyrja në fuqi e deklaratës më 2 shtator 1990 shënoi pikën kulmore **të angazhimeve gati 70 vjeçare për ta bërë bashkësinë ndërkombëtare që të njohë nevojat e veçanta dhe ndjeshmërinë e fëmijëve. Dhjetë vjet pas aprovimit, ratifikimit e saj kanë mbetur ta nënshkruajnë vetëm dy shtete, Somalia dhe SHBA.**

29 Neni 3 Konventa Për të Drejtat e Fëmijës: 1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. 2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ato marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse. 3. Shtetet palë sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

Konventa cilëson në preambulën e saj se **“familja [është] njësi themelore e shoqërisë dhe mjedis natyror** për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj veçanërisht të fëmijëve, **duhet të ketë mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi”**.

Të drejtat e Konventës mbështeten mbi parimet themelore të përgjithshme të cilat janë: Neni 2 mbi ndalimin e diskriminimit; Neni 3 mbi interesin më të mirë të fëmijës; Neni 6 mbi të drejtën për jetë, ekzistencë dhe zhvillim.

## • Kodi i Familjes

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë<sup>30</sup> sanksionon të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore të cilat garantojnë, mbrojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet në marrëdhëniet familjare. Në respektim të Kushtetutës, Kodi i Familjes garanton dhe konsideron parësore mbrojtjen e të miturit dhe interesin më të lartë të tij<sup>31</sup>. Në Kodin e Familjes, në lidhje me marrëdhëniet e fëmijës me prindërit dhe familjen e tij ose me rastet që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijës etj, i kushtohet një rëndësi e veçantë të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit, familja ose përfaqësuesit e tyre ligjorë. Sipas këtij Kodi, prindërit përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre<sup>32</sup>, me një vëmendje të veçantë ndaj detyrimit dhe të drejtës së prindërve për tu kujdesur për ushqimin e fëmijës, arsimimin e tij, etj. Kodi i Familjes parashikon detyrën dhe të drejtën e prindërve për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët e lindur nga martesë ose jashtë martesë (neni 4), të cilët në rast nevojë ndihmohen nga shteti.

Neni 158 i K. Familjes parashikon: “Prindi, që nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, ruan të drejtën të mbikëqyrë mbajtjen dhe edukimin e fëmijës e për pasojë të informohet të konsultohet për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e tij. E drejta e vizitës dhe e banimit nuk mund t’i refuzohen..” Në këtë mënyrë prindi të cilit i është caktuar përgjegjësia prindërore me vendim gjykate duhet ti krijojë fëmijës kushte të mira familjare dhe shpirtërore, një ambient të qëndrueshëm si dhe të tregojë një përkujdesje dhe përkushtim më të madh lidhur me këtë fakt, ndërkohë që sipas nenit 158 të K. Familjes parashikohet që, prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, duhet të krijojë lidhje afektive me fëmijën duke patur një kontakt të shpeshtë me të si dhe detyrohet të kontribuojë në rritjen dhe edukimin e fëmijës së tij, kjo duke mbajtur parasysht dhe gjendjen familjare, ekonomiko financiare të të dy palëve.

30 Ligi Nr. 9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes.

31 Neni 2 K. F Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

32 Neni 3 Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të 1indur nga martesë ose jashtë martesë.

Shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

Neni 161 i K. Familjes parashikon: *"Në vendimin e zgjidhjes së martesës caktohet dhe kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën ..."* Nga formulimi i kësaj dispozite rezulton se caktimi i shumës së nevojshme për shpenzimet që lidhen me fëmijën, do të shqyrtohet nga gjykata edhe në rast se palët nuk e kërkojnë. Kontributi material, është i një rëndësie parësore për mirërritjen e fëmijës, ndaj ligji ka konsideruar që përcaktimi i tij nuk mund t'i lihet ekskluzivisht prindërve të fëmijës. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, imponon ndërhyrjen e gjykatës, e cila sipas rastit, do të zgjidhë konfliktin ndërmjet prindërve nëse këta nuk bien dakord mbi masën e këtij detyrimi.

Për shkak se ende legjislacioni ynë familjar nuk ka përcaktuar një masë konkrete të kufirit minimal dhe atij maksimal ku të mbështetet Gjykata kompetente në caktimin e detyrimit për ushqim, Gjykata e Lartë e RSH ka vlerësuar se gjykatat e faktit, referuar kriterëve ligjore të parashikuara në nenet 158 dhe 201§2 të Kodit të Familjes, kanë vepruar drejtë në përcaktimin e këtij kontributi duke marrë në konsideratë raportin e burimeve të të ardhurave të paditësit/es me ato të paditurës/it si dhe këto të ardhura në raport me nevojat e fëmijës/eve dhe mundësinë ekonomike të palës së detyruar. Pra, gjykatat kanë caktuar masën e detyrimit ushqimor të palës së detyruar për fëmijën/ët nisur nga raporti midis:

- (i) nevojave të fëmijës/ve;
- (ii) mundësive ekonomike të të paditurit/ës, mbi të cilin/ën bie ky detyrim dhe ato të paditëses/it, së cilës/it i është lënë fëmija/ët për rritje dhe edukim.

Neni 192 i Kodit të Familjes parashikon se: *"Detyrim për ushqim kanë prindërit ndaj fëmijëve"*.

Neni 196 i K. Familjes parashikon: *"Prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t'u jetë hequr përgjegjësia prindërore."*

Neni 197/3 i K. Familjes parashikon: *"Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç<sup>33</sup>"*.

Neni 201 parashikon se *"Detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Ai nuk duhet të kapërcejë atë që është e nevojshme për jetën e personit që përfiton detyrimin për ushqim, duke pasur parasysh rrethanat e jetës së tij"*.

Praktika gjyqësore ka vlerësuar se detyrimi për ushqim i fëmijëve ka të bëjë me mirëqenien materiale të fëmijëve, pra ai është detyrimi thelbësor që rrjedh nga përgjegjësia prindërore. Në caktimin e detyrimit për ushqim, gjykata nisët nga interesi më i lartë i fëmijës, por edhe nga burimet dhe kushtet konkrete ekonomike

33 Neni 197 i Kodit të Familjes sipas të cilit: *"Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç"*.



të palëve. Në caktimin e shumës si kontribut ushqimor, gjykata merr parasysh krahas gjendjes ekonomike të palës së paditur dhe nevojat më themelore e jetike të të paditurit edhe moshën dhe nevojat materiale të fëmijës së mitur për mirëritje dhe edukim.

Sipas praktikës gjyqësore, është theksuar se në çdo moment që situata ekonomike e njërit prej prindërve mund të ndryshojë, jo vetëm i/e padituri/a mund të kontribuojë vullnetarisht për mirëritjen e fëmijëve së/të tij/saj, por në çdo rast, bazuar në nenin 207 të Kodit të Familjes, secili nga prindërit ka të drejtë të kërkojë shtimin, heqjen ose pakësimin e detyrimit për ushqim.

Neni 209 i K. Familjes parashikon: *“Personi që ka detyrimin për ushqim ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht...”*.

Neni 210 i K. Familjes parashikon: *“Detyrimi për ushqim fillon nga data e ngritjes së padisë....”*.

Neni 215 i K. Familjes parashikon: *“Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij”*.

## • Ligji për të Drejtat e Fëmijës

Ligji Nr. 10347, datë 4.11.2010 Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, ka në fokus përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën (Neni 1). Qëllimi i tij konsiston në mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjisllacionit në fuqi; në marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetit, bazuar në interesin më të lartë të tij; në marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës; si dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës (neni 2).

Si pjesë thelbësore të tij ligji mbështetet mbi parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si princip mbizotërues, në të gjithë vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose legjisllative. Ndër parimet e tjera, shtylla të këtij ligji, janë dhe ato të barazisë dhe eliminimit të të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinionëve të shprehura apo të bindjeve të prindërve / përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij. Ky ligj garanton respektimin e përgjegjësive, të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën. Për

fëmijën ky ligj kërkon krijimin e kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim, respektimin e mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e saj (Neni 5).

Në nenin 8 të Ligjit në fjalë, njihet e drejta që ka fëmija për të qëndruar pranë prindërve të tij si dhe të mos ndahet prej tyre veçse kur një gjë e tillë është çmuar nga Gjykata e cila e ka vlerësuar se është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës<sup>34</sup>.

Në mbështetje të nenit 18, ligji garanton të drejtën për nivel jetese të përshtatshëm për fëmijën, kjo në përputhje me zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Një tjetër mbrojtje që garanton ligji është mbrojtja sociale<sup>35</sup> e cila i ofrohet të miturit nga prindit/përfaqësuesi ligjor, mbrojtje e cila jepet duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Një garanci tjetër për mirëritjen dhe edukimin e fëmijës përbën ushtrimi i kujdesit prindëror që i siguron fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale. Për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, prindi/kujdestari ligjor për të garantuar mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës u kërkon autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar<sup>36</sup>.

34 Neni 8 Ligji për të Drejtat e Fëmijëve - E drejta për të qëndruar me prindërit 1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. 2. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të tij. 3. Prindi/përfaqësuesi ligjor nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës. 4. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtar i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, të arrestuar, të burgosur, të internuar, të dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij. 5. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendndodhjen e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës.

35 Neni 20 Ligji për të drejtat e Fëmijës: E drejta për mbrojtje sociale 1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet prindit/përfaqësuesit ligjor, mbrojtje sociale, përfshirë dhe sigurimet shoqërore. 2. Mbrojtja, kur është e nevojshme, duhet të jepet duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

36 Neni 28 Ligji për të drejtat e Fëmijës: Ushtrimi i kujdesit prindëror 1. Prindi/përfaqësuesi ligjor ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj. 2. Prindi/përfaqësuesi ligjor, për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ka të drejtë t'u kërkojë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës.

## • Kodi i Procedurës Civile i RSH

Kodi i Procedurës së Republikë së Shqipërisë në pjesën e IV-t të tij përcakton se cilët vendime apo akte administrative mund të jenë tituj ekzekutivë dhe për pasojë të ekzekutueshëm (neni 510). Sipas nenit 151, titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit i cili për rastet e parashikuara nga neni 150, shkronja a dhe b, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin, kurse për vendimet e gjykatave të huaja lëshohet nga Gjykata e Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, etj. Vendimi i ekzekutimit (urdhri) vihet në ekzekutim nga Shërbimi Përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbartuesit përmbartimor në bazë të kërkesës së kreditorit apo përfaqësuesit të tij ligjor të pajisur me prokurë (neni 515 K. Pr. C). Sipas nenit 516/a K. Pr. C. përcaktohet që përmbartuesi gjyqësor në çastin e fillimit të procedurës së ekzekutimit duhet të regjistrojë, në regjistrin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo kërkesë. Çdo përmbartues gjyqësor është i detyruar të njihet me të dhënat e regjistrit. Përmbartuesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim. Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbartuesi gjyqësor. Me kërkesën e debitorit, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethanat e tjera të çështjes, pasi dëgjon edhe kreditorin mund të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ta ndajë këtë detyrim në këste. Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës<sup>37</sup>.

Sipas nenit 522, kur nuk dihet banimi i debitorit, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, me kërkesën e përmbartuesit gjyqësor, pasi sqarohet edhe vetë për këtë rrethanë, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga përmbartuesi gjyqësor i emëron debitorin një përfaqësues, i cili shpërblehet fillimisht nga kreditori. Kur është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit me qëllim ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit, pa praninë e tij ose të një personi madhor të familjes së tij, me kërkesë të përmbartuesit gjyqësor, detyrohet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, përmbartuesi gjyqësor kërkon edhe pjesëmarrjen e dy dëshmitarëve të tjerë. Në rast nevoje, me kërkesë të përmbartuesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit. Në rastin e ekzekutimit të një detyrimi në të holla përmbartuesi gjyqësor, pas mbarimit të afatit për vënienë ekzekutim, fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Me kërkesë të debitorit, sekuestroja mund të vihet, përveç pasurive të rënduara me peng dhe hipotekë, edhe mbi një pasuri tjetër të tij, të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbartuesi gjyqësor çmon se ajo plotëson kërkesën e kreditorit (neni 527-528). Neni 529 për-

37 Neni 517 K.Pr.C

cakton një kategori sendesh mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestro por në lidhje me detyrimin ushqimor ai bën përjashtim, duke theksuar se nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës<sup>38</sup>. Neni 530 dhe 533 K.Pr.C përcakton rastet e sekuestros mbi shpërblimin nga sigurimi dhe mbi pagën e debitorit. Kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbaruesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre<sup>39</sup>. Dhe detyrimi ushqimor bën pjesë në grupin e kredive që paguhen me preferim. (neni 605 K. Civil)<sup>40</sup>. Kodi i Procedurës Civile përcakton në nenet 540 e në vijim (neni 540-604 K.Pr.C) procedurën që ndiqet nga përmbaruesi gjyqësor në ekzekutimin dhe vendosjen e sekuestros mbi sendet e luajtshme, sendet e paluajtshme, mbi mjetet e lundrimit dhe të fluturimit të debitorit, apo mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që një person i tretë i detyrohet atij, si dhe ekzekutimi mbi shumat e llogarive në banka. Dhe në këtë rast, kredia për detyrimin ushqimor paguhet me preferencë kundrejt kredive të tjera që rëndojnë mbi debitorin.

## 4.2. Problematika mbi procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtës familjare, konkretisht me detyrimet ushqimore

Praktika gjyqësore e viteve të fundit ka evidentuar raste vendimesh gjyqësore të cilat deri diku nuk i përgjigjen maksimalisht interesit më të lartë të të miturit. Kjo sidomos në rastet e divorceve kur fëmija ose fëmijët i lihen për rritje dhe edukim një ose të dy prindërve, ku disa herë shihen më tepër interesat e prindërve se sa të fëmijëve, ose në rastet e detyrimit ushqimor, ku shpesh herë fëmijët nuk marrin shumën e nevojshme për edukimin, arsimimin, dhe mirërritjen e tyre. Në Kodin e Familjes, Neni 2, përcaktohet se *"Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës"*. Gjithashtu Kodi i Procedurës Civile (neni 354 paragrafi 2, dhe neni 357) parashikohet që gjykata e merr vendimin e saj për emërimin e kujdestarit të të miturit ose zëvendësimin e tij, duke patur parasysh interesin e të miturit.

Ndërkohë që të metat e vëna re nga pushteti gjyqësor kanë të bëjnë pikërisht me respektimin e parimit *"interesi më i lartë i fëmijës"*:

38 Neni 529/6. ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;

39 Neni 537 K.Pr.Civile

40 Cit. Neni 605/b Kodi Civil i RSH: Paguhen me preferim, sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme: b) kreditë që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj.

- a) detyrimi ushqimor që akordon gjykata në përgjithësi, nuk është i mjaftueshëm për të siguruar rritjen dhe edukimin e fëmijës. Në pjesën më të madhe të rasteve vendimet e gjykatës nuk japin argumentet e nevojshme për të justifikuar përcaktimin e masës së pensionit ushqimor. Në raste të tjera ka vështirësi të provohen të ardhurat që siguron prindi, i cili nuk ka fëmijën në ngarkim, por që duhet të paguajë detyrimin për ushqim. Kjo ndodh për faktin se një numër i konsiderueshëm personash nuk regjistrojnë aktivitetin e tyre sipas kërkesave të ligjit, ose nuk kanë lidhur kontratë për punën që kryejnë. Sigurisht, kjo bën ndesh me interesat e të miturit për t'iu siguruar një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
- b) Gjykatat, ka raste që në një pjesë të vendimeve të tyre nuk shprehen fare për detyrimin për ushqim, ndërkohë që në Kodin e Familjes, ky është një detyrim që duhet të zgjidhet nga Gjykata. Gjithashtu në një numër vendimesh gjyqësore gjykata nuk shprehet për kështet, format dhe mënyrat se si do të realizohet pagesa e këtij detyrimi ushqimor nga prindi debitor.

Nëse do të studiohej praktika gjyqësore konkrete e këtyre viteve të fundit rezulton se ka raste kur prindi ushtron veprimtari private, por nuk paguan tatimet dhe nuk e deklaron këtë aktivitet. Gjykata, në rastet kur nuk ka dokumentacionin e duhur nuk vendos mbi bazën se ku do të mbështesë detyrimin financiar, pasi nuk ka mundësi të vërtetojë një burim financiar të palës që do të paguajë detyrimin konkret.

Gjithashtu një tjetër problem i hasur gjatë analizës së praktikës gjyqësore rezulton edhe emigrimi i shumë prindërve (kryesisht burra), të cilët duke qenë larg, kanë zgjidhur martesën dhe nuk paguajnë detyrimin ushqimor. Në këto raste gjykata nuk mund të njohë burimet financiare reale të tyre (për shkak edhe të mos paraqitjes së tyre në procesin gjyqësor) dhe përgjithësisht vendos një shumë mbi bazën e pagesës që jepet në rastet e papunësisë. Këto vendime mbeten të pazbatuara sepse prindi debitor nuk merr pagesë papunësie, pasi është larguar dhe nuk plotëson kushtet e ligjit për ta përfituar atë; në raste të tjera vendimi gjyqësor nuk bëhet i zbatueshëm, pasi organet kompetente të shteteve ku kanë emigruar nuk i njohin vendimet e gjykatave shqiptare; ose shtetasit emigrantë në këto vende punojnë në të zeza dhe nuk janë të regjistruar ligjërisht si punëkërkuar apo punëtorë pranë institucioneve kompetente; apo mungesës së bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndërkombëtar midis autoriteteve kompetente shqiptare dhe atyre ndërkombëtare për të bërë të mundur realizimin e ekzekutimit të detyrimit ushqimor në favor të fëmijëve apo pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Kjo ndikon në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, duke çuar në mos realizimin e të drejtës ligjore të palës së interesuar. Ky mosekzekutim brenda një afati të arsyeshëm i titujve ekzekutivë vjen si rezultat i pengesave të natyrës legjislative dhe praktike, si dhe mosrespektimit nga ana e autoriteteve të ngarkuara me ligj të akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë mënyrën e përmbushjes së detyrimeve të rrjedhura nga vendimet gjyqësore për organet e administratës shtetërore dhe entet publike<sup>41</sup>.

41 Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të gjykatës së shkallës së parë tiranë, me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, Periudha e monitorimit: Janar-Dhjetor 2014, QNL, Tiranë, 2015, fq. 64

# Konkluzione nga studimi dhe monitorimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pensionin ushqimor për fëmijët

(Me këndvështrim të posaçëm kur njëri prind ndodhet jashtë vendit)

- Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të një shteti tjetër në territorin shqiptar, si dhe të Shqipërisë në një territor tjetër, kërkon zbatimin e konventave ndërkombëtare përkatëse. Një vend të veçantë në këtë drejtim zë Konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”, e cila zbatohet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për detyrimin për ushqim në rastet ndërkufitare.
- Nga ky studim, kemi konstatuar se, njohja me këtë konventë është ende e pamjaftueshme në radhët e profesionistëve, veçanërisht të përbaruesve gjyqësorë, avokatët. Rastet e zbatimit të saj, janë të pakta dhe ende të papërfunduara, megjithëse ajo ka hyrë në fuqi nga viti 2013.
- Mungon praktika institucionale dhe procedurale me institucionet ndërkombëtare në ndjekjen administrativisht të rasteve për ekzekutimin e detyrimeve ushqimore, kur prindi debitor ndodhet jashtë territorit shqiptar.
- Ministria e Drejtësisë si autoriteti kompetent në bazë të kësaj konvente dhe të ligjit shqiptar për ratifikimin e saj, ka nisur disa procedura, por nuk ka përfunduar ende asnjërën prej tyre.
- Mungojnë të dhënat nga vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimi Përbarimor, mbi situatën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimit ushqimor, në përgjithësi, si dhe atij ndërkufitar në veçanti.
- Mungon informacioni për qytetarët me qëllim aksesin e tyre në shërbimet që ofron Ministria e Drejtësisë, ose organet e tjera për këtë çështje.

- Nuk ka një protokoll ose ndonjë praktikë të bërë publike të bashkëpunimit institucional midis institucioneve përgjegjëse vendase (shërbimi përmbartimor, Ministri e Drejtësisë, ministri të tjera, organet vendore etj.) për rastet e ekzekutimit të detyrimeve ushqimore, kur prindi debitor ndodhet jashtë shtetit.
- Detyrimi ushqimor gjatë proceseve gjyqësore, të cilat mund të zgjasin edhe për një afat të paarsyeshëm, nuk zbatohet.
- Procedurat për marrjen e shërbimeve përmbartimore janë me afate të gjata kohore dhe ka raste jo efikente.
- Strukturat e qeverisjes vendore janë ende të papërfshira në këtë çështje dhe të paangazhuara në identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve që janë përfitues të pensionit ushqimor në përgjithësi, ose kur prindi debitor ndodhet jashtë vendit.
- Mungojnë udhëzues si për palët, ashtu edhe për avokatët, me qëllim që Konventa të jetë një instrument miqësor dhe i lehtë për t’u zbatuar.

# Sugjerime

- I. **Në lidhje me ndryshimet në legjislacion dhe marrjen e masave pozitive nga ana e Shtetit.**
  - Të rishikohet legjislacioni familjar me qëllim parashikimin e mekanizmave dhe sanksioneve efikase ndaj prindërve/kujdestareve ligjorë lidhur me mosdhënien e mjeteve te nevojshme për një standard minimal të jetesës së fëmijëve të tyre.
  - Të rishikohet i gjithë legjislacioni përkatës me qëllim harmonizimin, me Konventën e Hagës.
  - Me qëllim zbatimin e Konventës së Hagës objekt studimi, mendojmë që përtej masave të parashikuara aktualisht në Kodin e Familjes, të parashikohen edhe mjete për ekzekutimin e vendimeve të tjera në legjislacionin përkatës, p.sh:
    - a) zbritjet nga pagesat dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore;
    - b) barrën ose shitjen e detyruar të pronës;
    - c) ndalesën në rimbursimin e taksave;
    - d) raportimin në zyrën e kredisë;
    - e) refuzimin, pezullimin ose anulimin e licencave të ndryshme (për shembull, lejet e drejtimit të mjetit, ushtrimit të aktiviteteve private, etj.).
    - f) kushtëzimin e lëvizjeve jashtë shtetit, nga pagesa e detyrimit ushqimor.
    - g) parashikimi i detyrimit të personave në radhë për të paguar në vend të personit debitor, së paku shpenzimet e mbijetesës për fëmijët.
  - Amendimi i Kodit të Familjes, për të garantuar lëshimin dhe zbatimin automatik të urdhrit të gjykatës si masë paraprake për pensionin ushqimor të fëmijës, gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit gjyqësor deri në vendimin e formës së parë të gjykatës. Ky parashikim duhet të shtrihet edhe në rastet e kujdestarisë.
  - Marrja e masave pozitive nga ana e organeve shtetërore, në formën e akteve ligjore e nënligjore, me qëllim krijimin e mundësive për punësimin e personave debitorë.
  - Parashikimi në legjislacion i rasteve për kompensimin e detyrimit ushqimor nga Shteti dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi, midis prindit që detyrohet dhe Shtetit.



- Përfshirja e “planeve të prindërimit” ne legjislacion si detyrim për t’u zbatuar nga gjyqtaret për të mbajtur të qëndrueshme mardhëniet prind-fëmijë dhe bashkëpunim institucional për të forcuar rolin e prindërve.

## II. Në lidhje me përgjegjësitë konkrete institucionale.

### Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrat e Përmbarrimit:

- Përgatitjen e protokolleve standarde për përcaktimin e qartë të përgjegjësiave të organeve përgjegjëse për zbatimin e Konventës së Hagës, si dhe të organeve që mund të ndihmojnë për zbatimin saj (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Brendshme etj.).
- Vendosjen në eficiencë të sistemit elektronik të menaxhimit të të dhënave të çështjeve përmbarrimore për detyrimin ushqimor dhe lidhjen e tij me sistemin e gjykatave, me qëllim monitorimin efektiv të zbatimit të këtyre vendimeve (veçanërisht në rastet kur prindi debitor ndodhet jashtë territorit të vendit);
- Përgatitja e një Manuali mbi zbatimin e Konventës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”, i cili do të përmbajë hapa konkrete për Ministrinë e Drejtësisë, gjyqtarët, avokatët, përmbarruesit, shërbimin social vendor, etj.
- Ngritja e një sistemi efikas për monitorimin e shërbimit përmbarrimor, privat dhe shtetëror për çështjet e pensionit ushqimor.
- Ngritja e një sistemi trajnimesh për përmbarruesit gjyqësorë në këtë fushë.

### Për shkollën e Magjistraturës dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë:

- Përgatitja e një plani trajnimesh për njohjen dhe zbatimin Konventës së Hagës
- Hartimi i një plani trajnimesh për gjyqtarët në këtë fushë.
- Hartimi i një plani trajnimesh për avokatët në këtë fushë.
- Marrja e përvojave pozitive dhe e zgjidhjeve të dhëna nga vendet e tjera lidhur me ekzekutimin e detyrimit për ushqim. Kjo mund të realizohet përmes një case-book ku për këtë konventë, në formën e rasteve konkrete, të tregohet rruga që ndiqet për shlyerjen e detyrimit për ushqim në rastet me elemente të huaj.

### Për organet vendore:

- Ngritja/koordinimi i strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor për zbatimin dhe monitorimin e “planeve të prindërimit” dhe ndërmjetësimin e konflikteve pas zgjidhjes së martesës.

